

*Odhise Grillo*

SSH-32

79



**PUSHKË  
NË BREGDET**

854-32

5

8 79

BIBLIOTEKA E MIKUT TË VOGËL TË LIBRIT

BIBLIOTEKA E SHTETIT

ODHISE K. GRILLO

887.

40905

# PUSHKË NË BREGDET

(Novelë për fëmijët e moshës së mesme shkollore)

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»





I

— Ai u shëronte plagët e trupit dhe të zemrës, prandaj i thërrisnin doktor! —

**N**jë veturë e markës «Fiat» po zbriste ngadalë të tatëpjetën thikë të Vërçës. Dritat e saja të fuqishme çanin errësirën e natës gjer tutje, nëpër kodrat e veshura me koçimare e me shqopë. Në veturë qenë tre vetë, një shofer i hollë e i gjatë si stekë bilardoje, një reshter italian, që e thërrisnin Armando Seti, dhe togeri i SIM-it Virgjile Boketi.

Në kthesë, Boketit, që po ndizte çibukun e madh e të bukur, iu përplas koka pas xhamit. Shoferi kish frenuar në vend.

— Çfarë pësove?

— Asgjë, sinjor tenente,<sup>1)</sup> — u përgjegj shoferi. — Me siguri fëmijët kanë vënë gurë në mes të rrugës.

Armandua dhe shoferi zbritën, lëvizën nga vendi gurët dhe i rrokullisën poshtë në greminë. Pastaj hypën përsëri në veturë dhe u nisën. Nuk bënë as pesëdhjetë metra dhe, në një kthesë më të fortë se e para, shoferit iu desh ta ndalojë përsëri veturën. Rruga ish zënë nga një shkëmb i madh.


Këtë radhë zbritën të tre. Kur iu afruan shkëmbit, u dëgjuan të shtëna pushkësh dhe plumbat u fishkëlyen afër veshëve. Pas pak shoferi ra i vdekur në mes të rrugës, Armandua shkau me vrap prapa veturës dhe u zhduk në errësirë, ndërsa togër Boketi nxori revolverin dhe shtiu andej nga u dukën flakët e pushkëve. Qëlloi një herë, dy, tri... po të katërtën nuk mundi më. E zuri një plumb në kokë dhe u shtri sa gjatë gjërë rrëzë shkëmbit që kishin vënë në mes të xhadesë.

Për ca çaste çdo gjë ra në qetësi. Katër vetë zbritën në rrugë, me nxitim. Ishin të armatosur me paticka italiane. Në gjoks kishin kryqëzuar gjerdanë fishekësh, ndërsa në brez kishin varur boniba e kobure. Dukeshin si komitet e Çerçiz Topullit. Njëri prej tyre mbahej fort pas krahut të shokut. Ish plagosur në kofshë dhe këpuca i qe mbushur

---

1) Zoti togër.





me gjak. Shoku i tij e uli në rrugë, nxori shaminë nga xhepi dhe nën dritën e fenerëve të veturës ja lidhi plagën. Dy të tjerët kontrolluan të vrarët e makinës dhe, pasi morën një automatik, një pushkë e dy revolverë, u bashkuan me shokët.

— Shoku Him, i treti u zhdruk...

I plagosuri tha:

— S'ka gjë. Atë që donim e vramë.

— Ta kërkojmë tjetrin?

— Jo.

— Po veturën ta rrokullisim në greminë?

— Akoma prisni?

Të plagosurin e mbështetën rrëzë një shkëmbi dhe të tre tok e shtynë veturën sa para-prapa, deri sa e rrokullisën në përrua. U dëgjua një zhurmë e madhe dhe pastaj u bë qetësi.

Kur ishin gati për t'u nisur, njëri tha:

— Dësh harruam fare...

— Çfarë?

— Po letrën që shkruam?

Njëri shkoi dhe i vuri një letër në gjoks togerit. Në të shkruhej: «Kështu do ta pësojnë gjithë fashistët dhe tradhëtarët!» Pastaj të katër u nisën monopateve dhe, pas një ore, ishin në të hyrë të fshatit. Nuk kish asnjë dritë të ndezur, përveç asaj të karabinierisë. Një karabinier ja kish marrë këngës dhe një tjetër e shoqëronte me kitarë. Tingujt e zvergur, që lëshonte kitara, dhe zëri pak i ngjirur i karabinierit dukej sikur ngjallnin trishtim.

... Nënë jam shumë i gëzuar,  
se prapë tek ti do të kthej...



Ku ta dinin karabinierët se komandanti i tyre, toger Virgjile Boketi, nuk do të kthehej më kurrë tek e ëma në Torino?.. Ndofta nuk do të ktheheshin as ata vetë!

Të katër shokët u futën nëpër rrugica dhe, duke ecur rrzës, dolën në krye të fshatit.

Tani kënga nuk dëgjohej më. Ata trokitën në një derë të madhe, të lyer me bojë të verdhë, të cilën pas pak ua hapi një grua e thyer në moshë. U futën brënda. Të plagosurin e shtrinë në krevat, ndërsa tre të tjerët u shtruan këmbëkryq. E zonja e shtëpisë rrinte në këmbë.

— Nga kini qënë kështu, mor djem?

— Në të përpjetën e Vërçës, mëmë Xheje, në të përpjetën e Vërçës kemi qënë. Kemi ngrënë drekët e toger Boketit.

— Korba, po mos ju zënë...

— Pse të kemi ty?

— Ju fsheh mëmë Xheja juve, se ju ka si djem.

Himi u ngrit ndënjurazi në krevat dhe u tha shokëve:

— Dëgjoni këtu... Mua më lini në duart e mëmë Xhejes. Ajo do të dijë të më fshehë për mrekulli. Mos u bëni hiç merak.

— Po për plagën?

— Edhe për plagën do të kujdeset mëmë Xheja. Do të shkojë tek doktor Zota ta thërresë. Ju e njihni ç'njeri është ai. Për vrasjen e togerit do të gëzohet më tepër doktori se ne që e vramë.

— Shoku Him, të shkoj unë ta sjell doktorin?

— Në asnjë mënyrë. Ju të tre duhet të largoheni një orë e më parë. Së shpejti ndofta vijnë dhe rrethojnë fshatin. Ju e dini se për ne dyshojnë... Nisuni pra dhe takimin e kemi pas dhjetë ditësh në Shpellën e Shtufit. Mos harroni aksionin tjetër që na ka besuar Partia.

Ata të tre u ulën njeri pas tjetrit dhe e për-qafuan shokun e plagosur.

— Të shkuara dhe mirë u pafshim!

Mëmë Xheja i përcolli gjer tek dera e oborrit. Njëri i kapi dorën dhe i tha:

— Mëmë Xheje, kujdes Himin.

— Mos u bëni merak fare.

— Shko edhe tek doktori.

— Ikni të qetë, bir... Dritë t'ju bëhet nga-do që të shkoni.

U për-qafuan me mëmë Xhejen dhe të tre tok u zhdukën në errësirë.

Mëmë Xheja mbylli derën dhe u kthye në dhomë. I bëri një ponç të fortë Himin dhe ja dha. Ai nisi ta pijë mengadalë.

— Pije, se të bën mirë. Im shoq, kur qe komit, pinte shumë ponç. Edhe plagët me raki i lante.

— Po e pi, mëmë Xheje... Falemnderit...

— Tani shtrihu dhe rri rehat. Unë do të vete tek doktori. Derën po e mbyll nga jashtë. Po dë-gjove zhurmë futu këtu...

Dhe i tregoi një vend të fshehtë, prapa foto-grafisë së të shoqit.

— Ki mendjen mos të të shohë njeri rrugës apo mos të të dëgjojë kur t'i flasësh doktorit.

— Unë ua kam hedhur xhandarëve jo të mos ua hedh breshkaxhinjve.



Mëmë Xheja u nis për te doktori, ndërsa  
Himi u shtri dhe nisi të dremisë.

\* \* \*

**E** thërrisnin doktor, megjithëse ai nuk kish  
bërë shkollë as për infermjer. Kish vetëm  
pesë klasë fillore dhe asgjë tjetër. Ish i varfër e  
i këputur dhe jetonte fillikat... I kishin rënë  
mbi kokë gjithato fatkeqësi. Në fillim i kish  
vdekur e shoqja, pastaj djali i vetëm.

Këto dy humbje e kishin dëshpëruar shumë...  
Kish lënë mjekër e mustaqe të gjata dhe mbante  
një palë syza të mëdha. Po të mos kish rrobet  
plot arna, do ta merrje patjetër për ndonjë nga  
ata shkencëtarët e kohës së vjetër që plakeshin  
përmbi libra.

Fëmijët e donin shumë dhe, kur e shikonin rend-  
nin pas tij. Ai ulej në mes tyre dhe u tregonte pë-  
rralla të rreme e të vërteta. U tregonte për Bilbil  
Gjyzarin e për të dy Batot që e bënë Romën të  
dridhej, për qerozin shpuzë nga këmbët e nga  
mendja dhe për Skënderbeun me nam, për një  
div që mbyti kuçedrën dhe për Rrapo Hekalin  
e Gjolekën, për vajzën me yll në ballë dhe për  
Naimin, që kish shkruar gjithë ato këngë për Shqi-  
përinë... Dhe sa e sa gjëra të tjera u tregonte  
doktor Zota fëmijëve!

Ata, si shpërblim, e ndihmonin duke i mbu-  
shur ujë, i sillnin dru nga shtëpitë e tyre dhe pu-  
nonin tok me të në kopshtin që rrethonte kona-  
kun ku banonte.

Doktor Zota kish shumë miqësi edhe me

njërin nga mësuesit e shkollës fillore të fshatit, me Himën. Mësuesi i jepte libra, doktor Zota i lexonte dhe ja kthente. Pastaj mësuesi i jepte libra të tjera. Sa lexonte doktor Zota! Sa shumë dinte ai! Më shumë se të gjithë, më shumë bile edhe se kryetari i komunes, që hiqej si njeri me shkollë dhe që mbante kapele Evropë në kokë e bastun me dorezë të fildishtë në dorë!

Doktor Zota rriste në kopshtin e tij shumë barishte dhe me to bënte ilaçe. Kur sëmurej ndonjeri në fshat, apo edhe në fshatrat e tjerë rreth-errotull, menjëherë thërrisnin doktor Zotën, se doktor tjetër nuk kish në gjithë krahinën. Nuk kish as infermjer. Doktor Zota vraponte tek i sëmuri, e mjekonte dhe ikte pa marrë asnjë shpërblim. Edhe ilaçet që i përgatiste nëpër shishe e nëpër vazo, ua jepte falas të sëmurëve.

Dhe sa e sa herë të tjera u kish dalë përkrah fshatarëve të varfër doktor Zota! Njerin e mbronte në gjyq, kur donin t'i rrëmbenin tokën, tietrin e shkëpuste nga duart e fajdexhinive e të tagrambledhësve, që donin t'i merrnin shpirtin dhe një tjetër akoma e ngushëllonte me fjalë, që ishin ilaç për zemrën e dritë për sytë...

Nuk kish zemër më të pastër, më të dashur e më të mirë se zemra e doktor Zotës! Ajo rrihte për fshatarët. Po edhe fshatarët ama, linin kokën për të. Atij nuk i mungonte asgjë, as në dimër e as në verë. Kush i çonte një barrë dru, kush i bënte bukën, kush i jepte një pjatë lakra apo një tas me qumësht. Ai e kish plot shtëpinë gjithmonë. Çfarë të kishin fshatarët, do të kish edhe ai.

Doktor Zota, ai fshatar i varfër e i pashkollë, po me një barrë mend, kish mbirë si një lule e



bukur në Vërçë. Atë e kish rritur toka e fshatit të tij me dashuri e dhëmbje. Jeta i kish dhënë helme dhe ai u jepte njerëzve gëzim.

Se sa e donin fshatarët, e kishin shprehur në një fjalë të thjeshtë po të madhe: Doktor Zota! E kishin quajtur doktor një bashkëfshatarin e tyre, që u shëronte plagët e trupit dhe të zemrës edhe pse nuk kish mbaruar për doktor.

Po, ai ish doktor përmbi të gjithë doktorët. Atë e kish bërë doktor jeta!

\* \* \*

**M**ëmë Xheja trokiti dhe doktori, veshur me një këmishë të gjatë deri tek kërcinjtë, doli në shkallë. Nuk kish fjetur akoma. Ishte duke lexuar një libër.

— Kush është?

— Jam unë, doktor, mëmë Xheja. Më ka dërguar mësuesi, Himi.

Doktori hapi derën me nxitim dhe e shikoi mëmë Xhejen në fytyrë.

— Çfarë ka ngjarë?

— Asgjë... Himi është plagosur pak në këmbë dhe do që t'i vështroni plagën.


— Me çfarë është plagosur?

— Do të ta thotë vetë...

Doktori u fut brenda, u vesh shpejt e shpejt dhe doli në oborr me trastën e ilaçeve e me fener në dorë.

— Doktor, fenerin të mos e marrim, se mund të na shohin.

E shuan fenerin, e lanë tek shkallët dhe u



18

19

20

21

22

23

24

25

26

27

28

29

30

31

32

33

34

35

36

37

38

39

40

41

42

43

44

45

46

47

48

49

50

51

52

53

54

55

56

57

58

59

60

61

62

63

64

65

66

67

68

69

70

71

72

73

74

75

76

77

78

79

80

81

82

83

84

85

86

87

88

89

90

91

92

93

94

95

96

97

98

99

100



nisën. Pas pak ishin në dhomën ku qe shtrirë i plagosuri. Himi po dremiste kur mëmë Xheja hapi derën e dhomës. Sa dëgjoi zhurmë, Himi u ngrit ndënjurazi dhe i zgjati dorën doktorit.

Ndërsa doktori po i lante plagën e po ja lidhte me copa leckash të pastra të nxjerra nga një këmishë e vjetër, Himi i tregonte si e kishin vrarë tenente Boketin.

Doktori punontë dhe dëgjonte në heshtje. Kur Himi mbaroi së treguari, doktori ndezi një cigare dhe, duke nxjerrë fjolla të dëndura tymi, tha:

— Shumë mirë kini bërë! Më ju lumtë dora që e vratë qenin!

\* \* \*

**T**ë nesërmen në mëngjes Pirrua u zgjua më shpejt se herët e tjera dhe zbriti poshtë. Dësh të futej në dhomën ku ish i plagosuri për të marrë një kapele të vjetër prej kashte që dikur e kish mbajtur i ati. Shtyu derën, por ajo ish e mbyllur me çelës.

— Mëmë, pse e ke mbyllur dhomën?

— Kot,

— Hape, se dua të marr kapelen prej kashte. Do të shkoj të mbledh fiqtë.

— S'ke ku shkon sot. Fiqtë i mbledhim nesër.

Pirrua nuk ja vuri veshin s'ëmës, po shtyu derën fort. Në çast u dëgjua një çelës që u kthye nga brenda dhe dera u hap. Para syve të Pirros doli fytyra e verdhë dhe e hequr e mësuesit. Himi e kapi për dore Pirron, e tërhoqi dhe e uli në karrige. Vetë u shtri. Pirrua hodhi sytë nga kre-

vati. Këmba e mësuesit që e lidhur me fasha të përgjakura, ndërsa nën jastëk dukej diçka që shndriste. Me siguri do të që ndonjë revolver.

— Pirro!

— Urdhëro, zoti mësues.

— Ti je i rritur tanimë dhe kupton shumë gjëra...

Mësuesi heshti pak, pastaj vazhdoi:

— Mua më ndjekin fashistët. Jam plagosur pak në këmbë dhe kam nevojë për mjekim dy-tri ditë, prandaj nuk ika. Do të rri në shtëpinë tuaj. Mëma jote më pranoi. Po ti, më pranon?

— Rrini sa të doni. Gjithë shtëpia juaja është. Këtu nuk ju gjejnë dot.

— Kujdes veç: asnjë njeri nuk duhet ta dijë që jam këtu.

— Po ju vetë më thatë se tanimë jam i rritur dhe kuptoj shumë gjëra...

Himi e afroi dhe i përkëdheli kokën. Pirrua doli me vrap jashtë, duke tërhequr derën me forcë. Ngjiti shkallët dhe hypi në ballkon. Aty mëmë Xheja po ndente disa rrobe. Pirrua i tha:

— Mëmë, e di?...

— Çfarë?

— Tek ne është fshehur mësuesi.

— Unë e di përpara teje.

— Po pse nuk më the?

— Do të ta thosha më vonë...

Pirron nuk e mbante vëndi nga gëzimi. Mësuesi do të rrinte në shtëpinë e tyre gjërsa të shërohej.

Sa i mirë dhe i dashur ishte mësuesi i Pirros!

Po ku ishte plagosur dhe pse fshihej?

Këto pyetje bluante në mendje Pirrua.



## II

— Kështu do ta pësojë zoti  
Boketi dhe jo ne! — tha Himi. —

**R**eshter Armando Seti, kur dëgjoi krismat e pushkëve në pritën e Vërçës, u fsheh menjëherë prapa veturës dhe pastaj rrëshqiti në bokërrimën e përroit, gjersa zbriti poshtë fare. Aty qëndroi dhe mori frymë thellë. Tani nuk ndihe-shin më të shtëna. Filloi të ecë pa ditur se ku shkonte. Sikur të kish qëndruar edhe një minutë pa lëvizur, vetura që rrokullisën të panjohurit do ta kish zënë nën vete e do ta kish bërë copë-copë.

Duke ecur këmba doras, rruga e nxori afër përmendores që kishin ngritur italianët në kujtim të luftës italo-greke. Si e pa vendin mirë e mirë, si pa edhe përmendoren ca më tej, u siguria se nuk ish shumë larg fshatit. U struk në një guvë dhe priti e priti shumë kohë, ndofta dy orë. Asnjë njeri, asnjë lëvizje.

Tani e kish marrë pak veten, i kish ikur edhe frika e vdekjes që pa me sy. U nis për në fshat. Ecte rrëzave e hieve dhe, kur dëgjonte zhurmën më të vogël, ndalonte.

Më në fund ja ku u duk edhe fshati. Nëpër shtëpi ishin fikur të gjitha dritat. Vetëm në komandën e karabinierisë, lëshonte dritë të fortë një petromaks.

Armandua ngriti kokën. Në krye të fshatit u duk një dritë e zbehtë, që lëvizi gjer diku, u kthye prapë nga ish nisur dhe pastaj u zhduk.

Ish mëmë Xheja me kandil në dorë që po përcillte doktor Zotën.

Armandua hyri nëpër rrugicë dhe nisi të ecë me vrap. Kur u fut në komandën e karabinierisë, në dhomën e nënoficerit të rojës, u shtri në një karrige, piu ujin që i sollën në një mashtrapë të madhe dhe tha:

— Në të përpjetën e Vërçës na bënë pritë ca brigandë<sup>1)</sup>. Shoferi u vra. Mund të jetë vvarë edhe tenente Boketi...

Në karabinieri u dha alarmi. U ngritën të gjithë dhe rrëmbyen pushkët. Zilja e telefonit nuk pushonte. U lajmëruan postat e karabinierisë nëpër fshatra. U lajmërua edhe nënprefektura e Vlora. Vlora njoftoi Tiranën.

Në drejtim të Vërçës u nisën forcat italiane të nënprefekturës dhe tri makina e një autobлиндë me karabinierë nga Vlora. Në krye të forcave italiane erdhi vetë shefi i SIM-it për Vlorën, koloneli Luogotito. Bashkë me të erdhi edhe nënprefekti, Hysni Lepeni, që ato ditë ndodhej në Vlorë me punë.

---

1) Hajdutë.



Herët në mëngjes, në rrugën që e pret fshatin mes për mes, si shirit, u pa një plak i shoqëruar nga dy italianë. E kishin ngritur nga rrobet plakun e shkretë dhe e kishin detyruar të bëhej tellall. Plaku, i hollë e i gjatë, qëndroi si një shtyllë në mes të xhadesë dhe nisi të thërrasë:

— Mbani vesh, o fshat! Urdhër i zotit Luogotito dhe i zotit Hysni Lepeni: asnjë të mos dalë nga shtëpia. Ai që e thyen urdhërin do të pushkatohet në vend.

Plaku s'kish mbaruar së foluri, kur në xhade u duk një tufë dhensh, që iknin me të katra duke ngritur pluhur, dhe një plakë që i ndiqte nga pas, duke rendur me sa i hanin këmbët. Nga komanda e karabinierisë nisën të shtinin në drejtim të plakës. Një dele blegëriti fort dhe u shtri në mes të xhadesë me këmbë përpjetë. Plaka nisi të bërtasë dhe u kthye për në shtëpi duke qarë.

Këto ndodhën pikërisht atëhere kur Pirrua kish dalë në ballkon.

Kur dëgjuan tellallin dhe krismat, fshatarët nisën të dalin nëpër ballkone e dritare dhe të bisedojnë me njëri tjetrin. Në pak minuta të gjithë e morën vesh se ish vrarë tenente Boketi.

Po kush e kish vrarë?

Njëri thosh se e kishin vrarë ca të huaj me mjekër e me musteqe, veshur me tirqe e me qylaf në kokë. Një tjetër i thosh shokut që kish afër se do ta kishin vrarë djemtë e fshatit, për punën e Shabanit... Me siguri në këtë punë do të kish gjithë mësuesi, Himi.

Sidoqoftë, të gjithë thoshin nga zemra:

— T'i bëhet dita njëmijë atij që ja ka numruar në lule të ballit!

— Kështu do ta pësojnë edhe të tjerët. Ky është vetëm fillimi.

Ja pse fshihej mësuesi. Ja pse e ndiqnin italianët... Me siguri Himi do ta kish vrarë tenenten... E kish vrarë vetëm... apo me shokë?...

Këto mendoi Pirrua kur mori vesh se ish vrarë tenente Boketi.

Nëpër muret e kafeneve të fshatit italianët po ngjithnin beze të mëdha në ngjyrë të kuqe, të shkruara me nxitim. Ata që i kishin shtëpitë afër mundën të lexonin: «Tenente Boketi — presente!<sup>1)</sup>, Tenente Boketi — secondo re in Albania!»<sup>2)</sup>.

Ata që dinin italisht e kuptuan se ish vrarë jo një toger i thjeshtë, po një njeri me pozitë të madhe, një njeri që e qanin «mbreti i dytë në Shqipëri».

Kush ish toger Boketi?

Ish djali i një tregëtari nga Torinua. Djalë i vetëm. I përkëdhelur. I ati donte ta bënte jurist, po Boketi ish i dhënë pas armëve. I pëlqenin pantallonat me shirita, kapelet e mëdha të oficerëve, shpatat e varura në brez dhe spaletat e arta.

---

1) Toger Boketi — këtu! (d.m. th. është gjallë)

2) Toger Boketi — mbret i dytë në Shqipëri.



U fut në shkollën e karabinierisë dhe mbaroi shkëlqyer. I dhanë gradën toger. Me këtë gradë u fut në rojen e oborrit perandorak dhe u njoh me Benito Musolinin. Duçja e mori në rojen personale dhe do ta kish mbajtur për shumë kohë, ndofta përgjithmonë, sikur të mos kish ndodhur një ngatërrësë: toger Boketi u mpleks me një bandë vjedhësish dhe përfitoi mijra e mijra lireta. U desh ta largojnë. I dhanë gradën kapiten dhe e nisën për në Abisini. Atje bëri të nëndëdhjetenëndat dhe në pesë vjet arriti gradën e nënkolonelit.

Pas pushtimit të Shqipërisë, më 1939, duke njohur zotësinë e mikut të tij, Duçja e dërgoi toger Boketin në nënprefekturën e Rëmahës. Rëmahasit ishin trima të mëdhenj dhe nuk i qenë nënshtruar asnjë qeverie: as Turqisë, as Zogut. Duhej një dorë e fortë që të mund t'i nënshtronte. Dhe dorë më të fortë se toger Boketi nuk kishe ku të gjeje. Prandaj edhe Duçja dërgoi atë e jo ndonjë tjetër.

Kur erdhi në Rëmahë, Boketi kish gradën e kolonelit; megjithatë të tërë i thërrisnin toger Boketi. Ky emër i kish mbetur që nga koha kur shërbente në rojen personale të Duçes, që nga koha kur ish ngatërruar me bandën e hajdutëve.

Dhe, ç'është e drejta, Boketi ndjente kënaqësi të madhe kur i thërrisnin toger edhe pse ishte kolonel. Ndofta se i kujtoheshin vitet e bujësh-

me të rinisë dhe aventurat e shumta që kish bërë...


Toger Boketi e tregoi kush ish, që ditën e parë që vuri këmbë në Rëmahë. Menjëherë nisi për në Itali, nëpër ishujt e shkretë, dhjetra vetë. Pastaj, me kalimin e kohës, nisi të kërcënonte, të kërkonte ryshfet, të vinte gjoba, të fuste në burgje njerëz të pafajshëm. Një herë vuri njerëz e vrau pabesisht edhe një tregëtar që nuk i kish dhënë lekë nën dorë. Sa i egër, sa i pamëshirshëm dhe i pashpirt që ish toger Boketi! Nuk e kish shokun që ku lind dielli gjer tek perëndon!

Toger Boketi do të kish vazhduar të tijat, sikur të mos kish ndodhur ajo që ndodhi në një ditë gushti të vitit 1942. Në atë kohë, nëpër male kishin dalë partizanët e parë. Një prej tyre që edhe poeti i ri Shaban Seferi, nga Vranishti. Ai kish botuar nja dy libra me vjersha të thjeshta, me frymë popullore. Në kapak, për të nderuar vendlindjen, kish shkruar: Shaban Vranishti. Një vëllim e kish titullin «Ndjenjat e malësorit».

Në Vërçë e njihnin shumë mirë Shabanin. Sidomos e njihnin mësuesit dhe nxënësit. Ai kish vajtur disa herë në shkollë. Një herë u kish recituar edhe vargje të tij. Shabanin e njihnin edhe plot fshatarë nga Vërça. Ai kish hyrë e kish dalë në shtëpitë e tyre.



Dhe ja, tani Shabani kish dalë maleve për liri. Duke bredhur brigjeve e gërxheve të Çikës, i ndje kur këmba-këmbës nga dhjetra e dhjetra karabinierë, me në krye toger Boketin, Shabani ra në pritë. I vetëm luftoi gjer në fishekun e fundit, pastaj u hodh mbi italianët me bajonetë.



E shpagoi veten me tre karabinierë. Pastaj ra, i goditur në katër pesë vende nga plumbat e nga thikët.

Toger Boketi, që i dinte mirë lidhjet e Shabanit me fshatarët e Vërçës, që të frikësonte rëmahasit, nuk e çoi trupin e Shabanit në Vranisht. E solli në Vërçë dhe e vendosi në oborrin e shkollës. Aty u mblodhën plot fshatarë dhe shikonin të pikëlluar mikun e tyre. . . Toger Boketi, duke u rënë çizmeve me kamxhik, thosh herë pas here:

— Kush do të guxojë të ngrejë krye kundër nesh, do ta pësojë si ky! — dhe tregonte trupin e Shabanit.

Doktor Zota me Himin rrinin mënjanë dhe shikonin me sy të përbotur e gjithë dhimbje mikun dhe shokun e tyre, që ish shtrirë pa jetë. Kur foli togeri, Himi tha mengadalë, në mënyrë që ta dëgjonte vetëm doktori:

— Kështu do ta pësojë Zoti Boketi dhe jo ne!

Me këtë desh të paralajmëronte fundin e afërt të togerit.

Ky qe një betim.

Shabanin, atë që meritonte shumë nderime, e varrosën në ca ara të lëna shkretë, në mes





të lisave të mëdhenj degëgjërë. Mbi varrin e tij nuk u mbajt asnjë fjalim e nuk u vu asnjë copë gur apo dru si shënjë... Po të nesërmen, mbi varr, dalloje që larg buqeta me lule e kurora. Ata i kishin vënë të rinjtë e fshatit, të shtyrë nga mësuesi. Në kordelen që lidhte një buqetë me lule të freskëta, të kuqe si gjaku, dalloje katër gërma të thjeshta, që ua dinin kuptimin edhe çiliminjtë: V.F. — L. P.

\* \* \*

**G**jyqi partizan i Vërçës, që atë natë, e dënoi toger Boketin me vdekje. Zëri i Shabanit thërriste për hakmarrje. Hakmarrje thërrisnin nga ishujt e Italisë edhe të internuarit. Hakmarrje thërrisnin të gjithë në Rëmahë.

Gjaku duhej larë me gjak sa më parë. Dhe u la më 24 gusht 1942.

\* \* \*

**N**ëpër shtëpitë e dyshimta nisi kontrolli. Karabinierët hynin nëpër dhoma e qilarë, nëpër hatet e bagëtime e kudo. Megjithatë nuk gjetën ata që kërkonin. Në fund të kontrollit doli se në fshat mungonin katër vetë: Him Mehmeti, mësuesi i fshatit, dhe tre të rinj të tjerë: Xhel Bregu, Sul Hasi dhe Naim Baçi. Mungonin pikërisht ata për të cilët dyshonte karabinieria.

Me urdhërin e Luogotitos, nënprefekti, Hysni Lepeni, thirri në karabinieri kryeplakun dhe doktor Zotën, si përfaqësues të fshatit.

Në fillim u foli Luogotitua. Nga inati i merrej goja dhe gjysmat e fjalëve i thoshte italisht e gjysmat shqip.

— Kuptoni? Është vrarë amiko personale i Duçes<sup>1)</sup>. Sekondo re in Albania!<sup>2)</sup> Zi e madhe!

Pas tij nisi të flasë Hysni Lepeni:

— Zoti kryeplak dhe ti... Zota. Humbja e toger Boketit, që ju e dini mirë se mbante gradën e kolonelit, është një fatkeqësi e madhe që gjeti Italinë dhe Shqipërinë. (Nënprefekti fshiu sytë me shami). Atë e kanë vrarë djemtë tuaj. Katër djem nuk gjenden në fshat. Janë fshehur... Tre janë fshatarë e nuk marrin vesh nga politika. Në këtë rrugë antikombëtare i ka shtyrë mësuesi, Him Mehmeti, që është një komunist shumë i rrezikshëm...

...Nëqoftëse të katër djemtë nuk i dorëzoni gjer në drekë, me keqardhje të madhe ju them se do të arrestohen shumë familje dhe do të digjen shumë shtëpi. Besoj se ju nuk e dëshironi një gjë të tillë... Mos harroni se koka e toger Boketit nuk lahet dot me asgjë!

Kryeplaku me doktorin dëgjonin në heshtje. Hysniu vazhdonte të fliste. Kur ai mbaroi, kryeplaku tha:

— Do të bisedojmë dhe do t'ju kthejmë përgjigje.

U larguan të dy nga karabinieria dhe, pa shkëmbyer asnjë fjalë gjatë gjithë rrugës, shkuan nëpër shtëpitë e katër djemve që nuk gjendeshin

---

1) miku personal i Duçes.

2) mbreti i dytë në Shqipëri.



në fshat. Asgjë nuk dinin familjet për djemtë. As ndonjë tjetër nuk dinte gjë. Po edhe sikur të dinin, kryeplakut nuk ja thoshin kurrën e kurrës. Doktor Zotës po.

Afër drekës, doktori me kryeplakun shkuan dhe njoftuan Luogotiton dhe Hysni Lepenin se fshati nuk e dinte nga kishin shkuar të katër djemtë.

Lougotitua u bë si bishë, nisi t'i bjerë tavolinës me grushte dhe dha disa urdhëra të prera në italisht.

Urdhërat u zbatuan në minutë. Në disa drejtime u shpërndanë grupe karabinierësh. Të katër familjet e të arratisurve u mbyllën në një nga dhomat e karabinierisë. Në shtëpitë e tyre shpërthyen flakët. Fshati ra drejt shtëpive për të shuar zjarret po karabinierët rrinin me bajonetë mbërthyer dhe nuk linin njeri të afrohej.

Në mbrëmje flakët u shuan dhe nga shtëpitë vazhdonte të dilte një tym i zi e të përhapej një erë shkrumbi.

### III

— Ai kish moshën e lodrave, po lufta e kish bërë burrë qysh fëmijë. —

**N**ga frika e madhe, Armando Seti ish bërë dyllë i verdhë. Edhe në mëngjes, kur u paraqit tek kolonel Luogotitua e i tregoi me hollësi si kish ndodhur vrasja (duke folur më tepër për trimërinë e tij, për qëndresën heroike, që kish bërë e për dy brigandë, që gjoja kish plagosur), nuk i kish ikur çehreja e verdhë e dridhej si ta kishin zënë ethet. Armandua fliste dhe Luogotitua e dëgjonte ulur në një karrige të madhe prej kashte, duke thithur cigaren.

— Kur hyra në fshat, ora mund të ketë qënë plot njëzet e katër...

Luogotitua e ndërpreu:

— A të ra në sy ndonjë lëvizje?

— Si urdhëron. Pashë një dritë të zbehtë në krye të fshatit, tek shtëpia e Hasan Shkabës. U duk për një çast, pastaj u zhduk.

— Gjë tjetër nuk pe?

— Jo.

— Mirë, po si ike dhe e le trupin e tenentes në duart e brigandëve?

— Sinjor Luogotito...

— Aty të kishe vdekur si qen! Lëkura jote



s'vlen asnjë qindarkë para kolonel Boketit! Kup-  
tove?

Reshteri, gati pa frymë, kish ngrirë në që-  
ndrimin gatitu.

Luogotitua heshti pak, u ngrit më këmbë dhe  
thirri:

— Maskalcone!<sup>1)</sup> Në arrest!

Armandon e morën dy karabinierë dhe e li-  
dhën.

Luogotitua i ra ziles dhe në çast hyri një ka-  
rabinier.

— I thuaj Klaudios të vijë.

Dera u mbyll dhe pas pak u hap përsëri. Hyri  
nëntoger Klaudioja dhe mori qëndrim gatitu.

— Shtëpinë e Hasan Shkabës ta vëzhgoni që  
këtë minutë. Veç të mos bini në sy. Mirë?

— Si urdhëron.

— Në mbrëmje ta kontrollojmë. Mund të  
ketë ndonjë nga ata që kërkojmë.

Klaudioja nderoi dhe doli jashtë. Pas pak nga  
karabinieria u nis një patrullë prej tre vetësh në  
drejtim të shtëpisë së Hasan Shkabës.

Në mbrëmje, një togë karabinierësh, me në  
krye nëntoger Klaudio Bonfanten, rrethuan shtë-  
pinë e Hasan Shkabës. Atë çast në oborr nuk kish  
njeri. Pirrua ish ngjitur në pullas dhe po merrej  
me pullumbat. Mëmë Xheja po milte dhëntë në  
hajat, nga prapa shtëpisë.

Nëntogeri me revolver në dorë dhe pesë ka-  
rabinierë hapën derën e shtëpisë dhe u futën në  
koridor. Asnjë zë dhe asnjë zhurmë.

---

1) Maskara.



Hynë me radhë nëpër dhoma po nuk gjetën gjë. Hapën dollapët, shikuan nën krevat e kudo. I kthyen së prapthi të gjitha. Përsëri nuk gjetën gjë. Së fundi shkuan edhe në dhomën ku ish fshehur mësuesi. E shtynë derën me forcë po edhe këtu s'panë asgjë. Krevati i rregulluar për bukuri dhe mbi të jastëkë të mëdhenje të qëndisur. Në mur një fotografi shumë e madhe e Hasan Shkabës. Kish dalë i veshur me fustanellë, xhamadan e opinga dhe me pushkë në krah. Nga fotografia, Hasani shikonte i qetë, ndërsa prapa fotografi-së Himi rrinte me

revolver në dorë...

Karabinierët dolën në koridor. Nëntogeri hapi derën e fundit që të nxirrte jashtë, prapa shtëpisë. Me shami të ulur gjer mbi vetullë, duke parë



me bisht të syrit e duke i rrahur zemra fort nga frika se mos gjenin mësuesin, mëmë Xheja po milte dhentë. Nëntogeri diçka i tha italisht. Ajo u ngrit më këmbë dhe pyeti:

— Ç'kini me mua plakën?

— Bën sikur nuk di gjë, ë? Po kontrollojmë shtëpinë se ke fshehur një partizan!

— Nuk kam njeri për të fshehur. Perëndia e qeveria janë të mëdha, mund të kontrolloni ku të doni...

Nëntogeri para e karabinierët pas, u futën në hajatin e bagëtime. Kontrolluan nga të gjitha anët, po nuk gjetën njeri. Bile nuk gjetën as gjurma.

Të gjashtë tok i ranë rrotull shtëpisë. Kur po dilnin nga oborri, Bonfantia ngriti kokën dhe pa Pirron që po ushqente pulumbat. Nxitoi nëpër shkallë dhe u ngjit lart, në baxha, i ndjekur nga karabinierët. Pirrua atë çast po këndonte një këngë dhe bëri sikur nuk i pa.

— Prendi çuni!<sup>1)</sup>

Bonfantja i ngjeshi një pëllëmbë djalit. Pirrua u kthye nga nëntogeri dhe e pa me urrejtje. Karabinierët nisën të shikojnë rreth e rrotull.

— Ej, pikolino!<sup>2)</sup> Është fshehur ndonjë brigand këtu?

Djali e shikoi drejt në sy dhe e pyeti:

— Brigand? Nuk e di ç'do të thotë kjo fjalë...

— Partizan do të thotë!

— S'kemi partizanë ne. Babai është jashtë shtetit, vëlla e motër nuk kam... Unë dhe nëna jemi vetëm...

— Ashtu ë? Na pra!

---

1) Merre çuni!

2) Ej, vogëlush!

Bonfantja u kthye me rrëmbim e i ngjeshi një pëllëmbë tjetër. Pastaj nisi të zbresë shkallët. Pas tij shkuan karabinierët.

Kur po delnin nga dera e oborrit, Pirrua tha:  
— Deshe të gjesh partizanin? Na! Kaq ta bësh dhëmbin, nuk e gjen dot kurrë.

Pak më vonë zbriti tek mëmë Xheja. Të dy i ranë qark oborrit, pastaj u futën në shtëpi.

— Dil, zoti mësues.

Sa dëgjoi zërin e Pirros, Himi doli që prapa fotografisë së madhe të Hasan Shkabës.

Prapa fotografisë ish një si kafaz aq i gjërë e i lartë, sa që mund të rrije lirisht në të. Atë e kish ndërtuar vetë Hasani për t'u fshehur, në kohën që e ndiqnin xhandarët e Zogut.

— Na e morën të keqen! Ikën, o bir...

— Ikën, po mund të kthehen prapë.

— Zoti mësues... Le të kthehen sa herë të duan. Unë do t'i shoh që nga baxhaja dhe do të të lajmëroj, ashtu siç bëra sot.

— Jo, Pirro, jo. Është më mirë të ndërroj vend. Në mos sonte, nesër patjetër.

Mëmë e bir thanë njëzëri:

— Nuk të lëmë të ikësh!

— Do të iki patjetër. Shtëpinë tuaj e kanë në shenjë. Me siguri dyshojnë. Dikush do të ketë treguar ose... As vetë nuk di çfarë të them... Pse kontrolluan këtu?

Mëmë e bir rrinin dhe e dëgjonin. Mësuesi vazhdoi:

— Ti, Pirro, nesër do të interesohesh në se kanë kontrolluar ndonjë shtëpi tjetër. Po të mos kenë kontrolluar, duhet të iki nga ju një sahat e më parë. Shko tek doktor Zota dhe pyetë.



— Që tani po deshët.

— Jo, jo. Nesër.

Mëmë Xheja tha:

— Shtrihu në krevat, bir. Do të të sjell qu-  
mështin. Ti, Pirro, ngjitu në baxha.

Ikën të tre në drejtime të ndryshme. Himi,  
hyri në dhomë dhe, ndërsa po shtrihej në krevat,  
thosh me vete:

— Kur të mban populli në gjirin e tij, nuk  
mund të të gjejë njeri!

\* \* \*

**T**ë nesërmen në drekë Pirrua u kthye në  
shtëpi dhe menjëherë u fut në dhomën e më-  
suesit.

— E, Pirro, çfarë dëgjove në pazar?

— Asgjë, zoti mësues...

— Po doktorin e takove?

— E takova. I shkova në shtëpi dhe e gjeta  
tek po mbliidhte fiqtë në kopsht. Duke e ndih-  
muar, e pyeta në se kishin kontrolluar ndonjë  
shtëpi. Xhaxhi doktori më tha se nuk kishin kon-  
trolluar asnjë tjetër veç sonës.

— Ashtu? Po rrugës, pe karabinierë?

— Tek cepi i rrugicës sonë qe një patrullë  
me tre vetë.

— C'bënin?

— Rrinin... Ishin ulur dhe po pinin cigare.

— Epo, sonte duhet të ndërroj banesë.

— Mos ikë, zoti mësues. Këtu nuk ju gjejnë dot.

— Ti, Pirro, mos u mërzit. Ne do të takohe-  
mi prapë. Fashistët do t'i dëbojmë nga vendi ynë

dhe atëhere do të kemi kohë të rrimë bashkë sa të duash.

Pirrua uli kokën dhe nuk foli më. Mësuesi e shikonte me vërejtje. Mëmë Xheja hyri në dhomë dhe i pa të dy tek po rrinin të menduar.

— Ka ndodhur gjë?

— Jo, mëmë Xheje. Pirros i vjen keq që do të iki nga shtëpia juaj.

— Pse, e vendose?

— Po. Prandaj duhet të më ndihmoni që të shkoj në ndonjë vend tjetër. Shtëpinë tuaj e vëzhgojnë. Pirrua thotë se këtu afër ka një patrullë. Kuptohet se nga çasti në çast mund të kontrollojnë në befasi, që të më kapin. Pastaj, pas dy tri ditësh më duhet të iki. Dua të takoj shokët. Duhet të shkoj në ndonjë shtëpi më të dalë të fshatit që ta kem më lehtë për të ikur në male.

— Meqë qënka kështu, mirë. Po ku do të shkosh?

— Tek shtëpia e nënës së Lufterit. Atje nuk besoj të dyshojnë. I biri është në kurbet. Ajo është vetëm fare. Do të shkoj qysh sonte.

— Po ecën dot?

— Këmba nuk më dhemb fare. Ka qënë plagë e lehtë.


— T'i themi doktor Zotës që të vijë të të ndërrojë plagën?

— Jo. E ndërroj vetë, se m'i ka lënë të gjitha ç'duhen.

— Mirë, bir, si të duash. Ne sonte do të kontrollojmë mirë e mirë rrugën, gjer tek shtëpia e Lufterit, pastaj, njeri para e tjetri prapa, do të të përcjellim.



Në qiell kish dalë një bri hëne. Yjtë vezullo-  
 nin me mijra. Nga jugu frynte një erë e  
 lehtë dhe e freskët. Në fushën këndonin bulkthit,  
 ndërsa në moçale bretkocat ngjireshin duke bër-  
 titur. Diku afër dëgjoheshin zile bagëtish. Në det  
 ndriçonin fenerët e barkave të peshkimit.



Himi doli në oborr, u mbush me frymë dhe  
 ngriti kokën lart.

— Ç'natë e bukur...

Në çast, në derën e oborrit u duk koka e Pirros.

— Asnjë njeri nuk ka rrugës. Shkova gjer tek  
 shtëpia e Lufterit.

— Epo, nisemi atëhere.

Pirrua përpara dhe mësuesi njëzet-tridhje-  
 të metra pas, nisën të ecin rrëzave e hieve. Prapa  
 mësuesit, po njëzet-tridhjetë metra larg, ecte mëmë  
 Xheja.

Një zog fluturoi mbi kokën e Pirros. Ai u

tremb një çast dhe mbajti këmbët e frymën. Qëndroi edhe mësuesi. Pastaj filluan prapë rrugën.

Kur iu afruan shtëpisë së Lufterit, ndaluan dhe mbajtën vesh: asnjë zhurmë, asnjë zë. Mëmë Xheja u afrua, i hodhi duart në qafë mësuesit dhe i tha:

— Zoti të ruajtë, o bir!

— Faleminderit, mëmë Xheje.

Pastaj Himi u përqaftua me Pirron:

— Mos më harro, Pirro!

— Kurrë, zoti mësues!

Sytë e Pirros dhe të mëmë Xhejes u mbushën me lot. Vetëm në sytë e Himi nuk kish lot.

Mësuesi eci përpara në majë të gishtërinjve, ndërsa Pirrua me të jëmën qëndruan rrëzë murit si të ngrirë. Himi iu afrua derës dhe trokiti lehtë... Dikush e hapi dhe, pas pak, e mbylli me forcë. Në çast u dëgjua një zhurmë e madhe dhe disa fjalë të shkëputura italisht.

Mëmë Xheja me Pirron nxituan për në shtëpinë e Lufterit. Hapën derën në çast dhe panë mësuesin që e kishin kapur përkrähësh katër karabinierë. Nga shkallët po zbrisnin të tjerët me vrap.

— Zoti mësues!

— Bir!

Dy karabinierë u kthyen me vrap dhe kapën mëmë Xhejen. Nga shtëpia dolën me të shpejtë karabinierë të tjerë. Qenë një togë e tërë. Në krye kishin nëntoger Bonfanten.

— Per dio!<sup>1)</sup> Më në fund të kapëm!

Himi e shikoi gjithë inat nëntogërin dhe buzëqeshi me ironi.

---

1) Për zotin!



Mësuesin dhe mëmë Xhejen i morën me vete, ndërsa Pirron e shtynë me kondakët e pushkëve, Pas pak morën dhe nënën e Lufterit. Në të dalë të oborrit u bashkuan të tërë dhe u nisën për në karabinieri. Mësuesin, edhe pse i kish duart të lidhura, e mbanin përkrahu nëntogeri me një reshter qimekuq. Të tjerët, para e prapa, i kishin drejtuar grykat e pushkëve. Mëmë Xhejen e nënën e Lufterit nuk i mbante asnjë. Ato ecnin kokulur.

Mëmë Xheja qante me lot të hidhur, se nuk qe e zonja ta ruante Himin, ashtu siç u kish premtuar shokëve të tij.



— Korba unë! — thoshte me vete. — Si e ruajta kaq kohë dhe pastaj e dorëzova me duart e mia, që m'u thafshin e m'u bëfshin dru, jarebi! O zot, më lësho një rrufe!... Si nuk hymë ne më parë të kontrollonim shtëpinë e Lufterit?... S'më vjen keq për vete, se unë plakë jam e nuk kanë çfarë të më bëjnë... Më vjen keq për mësuesin. Ai nuk ka asnjëri këtu, në fshat. Ka ardhur nga larg që të na mësojë fëmijët... Kushedi nga i ka të tjtë...

Ajo po hante veten me dhëmbë, nga inati.

— Po si e kapën, vallë? Si ndodhi kjo e papritur?

Mëmë Xheja nuk dinte gjë. As Pirrua. As mësuesi.

Ja si kish ndodhur:

...Kur Pirrua kish shkuar gjer tek shtëpia e Lufterit për të kontrolluar rrugën, nga një rrugicë po vinte një togë me karabinierë. Ai nuk i pa dhe nuk i dëgjoi se ata kishin qenë akoma shumë larg. Kur qe kthyer për të lajmëruar mësuesin, karabinierët kishin hyrë brënda në shtëpinë e Lufterit dhe po e bastisnin. Tek dera kishin lënë roje dy vetë. Në atë kohë, toga të tjera karabinierësh po bastisnin shtëpi të tjera nëpër fshat. Kontrollonin ato shtëpi për të cilat dyshonin.

Dy karabinierët që kishin qëndruar roje, ishin futur brënda dhe po prisnin pas derës. Kishin nderur nga një cigare dhe... mbajtën frymën se po dëgjoheshin këmbë... Ishin bërë gati... Mësuesi kish trokitur dhe pas pak, një karabinier ja kish hapur derën. Himi kish dyshuar dhe kish dashur të kthehej e t'ja mbathte me vrap tatëpjetë,



po kish qënë tepër vonë. Karabinieri e kish kapur fort për xhakete, ndërsa tjetri i kish mbyllur derën me forcë dhe i kish vënë krahët. I pari i qe hedhur përsipër, pasi e kish futur brënda. Në çast kishin ardhur dy të tjerë që po kontrollonin kopshtin. Edhe ata i qenë hedhur përsipër. Mësu-esi nuk kish mundur të bënte asnjë përpjekje për të shpëtuar... As revolverin nuk kish mundur ta përdorë...

Karabinierët e kishin çarmatosur, e kishin lidhur, dhe pastaj ngjanë ato që mëmë Xheja dhe Pirrua i panë me sytë e tyre.

\* \* \*

**D**uke ecur rrugës, për në komandën e karabinierisë, mëmë Xheja kthente kokën prapa nganjëherë dhe i thërriste të birit:

— Pirro, bir! Shko tek gjyshja.

Ecte edhe pak e pastaj kthehej prapë:

— Pirro, bir! Do të kthehem përsëri në shtëpi, mos qaj.

Një herë i foli edhe mësuasi:

— Bëhu burrë, Pirro!

Pirrua ecte pas karvanit të karabinierëve dhe hante thonjtë me dhëmbë. Prapa komandës së karabinierisë ndaloi. Qëndroi disa çaste, sa u zhduk edhe karabinieri i fundit e s'mbeti tjetër veç rojes, pastaj u kthye prapa. Ecte dhe as vetë nuk dinte ku shkonte. Dikush i foli. Pirrua ktheu kokën dhe pa doktor Zotën.

— Pirro, ku shkon kështu?

— As unë nuk e di...


— Po pse je i mërzitur?

Pirros i rrodhën lot:

— Karabinierët morën mëmën, mësuesin dhe nënën e Lufterit...

— Si the?!

Doktor Zotës i ra feneri nga dora. Shkoi me vrap dhe hapi derën e oborrit. Pirrua hyri brënda. U ulën përballë njëri tjetrit dhe rinin të heshtur.





Nga oborri i doktor Zotës, shtëpia e Pirros dukej shumë mirë. Hodhi sytë andej dhe pa flakët, që po përpinin çatinë. Edhe në shtëpinë e Lufterit u dukën flakët.

— Na e dogjën edhe shtëpinë, xhaxhi doktor...

Doktori i ra shpatullave:

— Për shtëpinë pyet ti?... U rrite tani dhe e ndërton vetë më të mirë, apo jo?

Pirrua piu një gotë ujë dhe nisi t'i tregonte doktorit ato që kish parë. Doktori i dëgjonte në heshtje dhe herë pas here fshinte syzat me një pece. Pastaj heshtën të dy. Pirrua u ngrit dhe desh të ikte.

— Natën e mirë, xhaxhi doktor...

Doktori e kapi për krahu.

— Ku do të shkosh tani natën?

— Tek gjyshja... Mund të bëhet merak...

— **Sonte do të rrih këtu. Nesër në mëngjes shko tek gjyshja. Mirë?**

Pirrua nuk foli. U futën brenda në dhomë. Doktori piu pak çaj. Pirrua nuk hëngri fare edhe pse doktori e luti disa herë. Rrinte i heshtur dhe shikonte në mur një fotografi të madhe të Skënderbeut...

...Ah, sikur të ishte si Skënderbeu! Do ta niste kalin me revan dhe drejt e në karabinieri. Do të priste me shpatë karabinierët dhe do ta li-  
ronte mësuesin, të jëmën dhe nënën e Lufterit.

Mendimet ja ndërpreu doktori:

— Ç'po mendon, Pirro?

— Asgjë, xhaxhi doktor... Mendoj për mësuesin, për mëmën dhe për nënën e Lufterit. Më duket se i futa unë në burg që të tre.

— Ti s'ke asnjë faj. Çdo gjë mund të ndodhë në këtë botë...

Doktori e vazhdoi me vete mendimin që e la për gjysmë: «Ti ke moshën e lodrave... Lufta po të bën burrë qysh fëmijë...»

\* \* \*

**M**ëmë Xheja ish martuar ca e thyer në moshë. Ajo kish marrë një burrë të ve, rreth pesëdhjetë vjeç, që quhej Hasan Shkaba. Hasani kish qënë trim i marrë e gjithë jetën e kish kaluar maleve. Me pushkë kish luftuar më 1920 kundër italianëve e me pushkë më 1924 kundër Zogut. Pastaj kish ikur jashtë dhe ish kthyer aty nga viti 1930. Gruaja e parë i kish vdekur atëhere. Hasani qe martuar me Xhejen po nuk kishin jetuar gjatë bashkë. Pas pesë muajsh, kur mëmë Xheja kish qënë me barrë te Pirrua, Hasani qe detyruar të arratisesj përsëri. Sikur një ditë më shumë të kish qëndruar në fshat, do ta kishin arrestuar xhandarët. Zogu kish dhënë urdhër ta arrestonin, pasi kish rënë në erë për punën e tij. Po ta kishin zënë, do të ish kalbur në burgje gjithë jetën.

Pirrua tani ish dymbëdhjetë vjeç djalë, po nga pamja të jepte përshtypjen se ish shumë më i madh e më i pjekur. Atë vit bënte klasën e pestë të shkollës fillore. Për katër vjet me radhë, kish patur mësues Him Mehmetin.

Babanë nuk e kish njohur dhe kushedi në do ta takonte vallë ndonjëherë... Kur ja, i morën edhe nënën. I vinte për të qarë, po nuk jepej. I mbante lotët me zor. E quante veten burrë. Kështu



i kish thënë mësuesi, kështu i tha edhe doktori pak më përpara.

— Pirro, pa më këndo atë këngën e dy partizanëve vlonjatë se më pëlqen shumë... Ka një melodi që të mallëngjen... E kam dëgjuar nja dy herë, po nuk e kam mësuar dot. Ngadalë këndoje se mos na dëgjojnë. Sot ka veshë edhe muri.

— Cilën, xhaxhi doktor? «Dalngadal' po vjen behari»?

— Po, atë.

Pirrua nisi të këndojë me zë të ulët:

... Dalngadal' po vjen behari,  
dalngadal' po na vjen,  
nëpër fusha rritet bari,  
dalngadal' po na vjen.  
Po na vjen, po na vjen,  
bota zjen, bota zjen,  
shokët tan' kjo luft' po na i rrëmben!

Doktori i shtrirë në krevat pëshpëriti:

— Edhe më ngadalë, Pirro... Kushedi, mund të ketë njeri në rrugë dhe na dëgjon.

Pirrua e uli zërin akoma më shumë.

— Sa mirë që e këndove, Pirro! Po kush ta ka mësuar?

— Mësuesi, xhaxhi doktor.

— Vetëm këtë ju ka mësuar?

— Edhe të tjera.

— Pa më këndo një tjetër...

Pirrua filloi përsëri:

...Drita dal ka herë,  
po troket një derë,  
cilnie, or të mjerë,  
se nuk dilni dot.

Doktori e ndërpreu:

— Kjo është kënga e Perlat Rexhepit, ë? Atë nuk e kam njohur. Të jatin, Rexhepin, dhe xhaxhanë, Lazen po. Perlati u ka ngjarë atyre, se janë patriotë. Bile ua ka kaluar. Të duhet t'i ngjash Perlatit, Pirro.

... Dalogadal, po vjen beqari,  
dalogadal, po na vjen.  
nëpër fusha rritet bari,  
dalogadal, po na vjen.  
Po na vjen, po na vjen,  
dota vjen, dota vjen,  
shokët tan' ajo lut, po na i rëndojnë!

Doktori i shtrijë në kryevepë beqarët:  
— Këmbë me ngadalë, Pirro. Kështu, mund  
të kështë abet në trupë, dhe na bëjton.  
Pirroka e mli xhaxha shoms me shoms.  
— Sa mirë që e këndove, Pirro! Po kështë të  
mësuar?  
— Mësuar, xhaxhi doktori.  
— Vetëm këtë ju ka mësuar?  
— Edhe të tjerat.  
— Pa më këndo një tjetër.  
Pirroka filloi qërshët:



#### IV

### — Poshtë fashizmi me gjithë galeta! Lironi mësuesin! —

**T**ë nesërmen Pirrua nuk shkoi në shkollë. Edhe shumë fëmijë të tjerë nuk shkuan. Klasa e pestë kish ditë që kish mbetur pa mësues dhe nuk bënte mësim.

Pirrua shkoi nga gjyshja, u suall nja dy herë nëpër oborr e nëpër kopësht, hëngri diçka shpejt e shpejt dhe pastaj doli në rrugë. Aty takoi shumë shokë. Ata i afroheshin, i jepnin dorën dhe e përqaфонin. Nuk dinin çfarë t'i thoshin. Dy gra e puthën duke qarë dhe i dhanë një grusht arra.

Ai eci më tutje me duar në xhepa. Gjyshja e ndoqi nga prapa deri në një farë vendi, pastaj u kthye në shtëpi. Para se të kthehej i tha:

— Mos harro të vish të hash drekë, Pirro.

— Nuk më hahet, moj gjyshe. Për darkë do të vij.

— Mos bridh rrugëve.

— Jo.

— Mos eja vonë.

— Jo.

Pirrua ndaloi tek sheshi përpara kafeneve.

Bezët e kuqe, të shkruara italisht, qëndronin akoma varur nëpër mure. Nëpër kafene pothuajse s'kish njerëz.

Dy shokët e Pirros, Agimi dhe Zihniu zbritën në shesh me një frymë dhe iu afruan atij. E për-qafuan, dhe Zihniu i tha:

— Të kërkuam anëmbanë fshatit, po nuk të gjetëm.

— Isha nga gjyshja ...

U ulën në disa gurë ku zakonisht rrinin bu-rrat që luanin kollçinë. Asnjëri nuk fliste. Që-ndruan gjatë kështu, pastaj Pirrua tha:

— Ikim?

— Ku të shkojmë?

— Në kopshtin e gjyshes sime. Kam për t'ju thënë diçka. Nuk duhet të na dëgjojë njeri.

— Mirë, shkojmë.

U nisën të tre, njëri pas tjetrit. U kthyen e u sollën në disa rrugica të ngushta, të shtruar me kalldrëm, pastaj hapën derën e një gardhi dhe u futën në kopsht.

Gjyshja e Pirros e kish shtëpinë në fund të fshatit. Afër shtëpisë kish një kopsht të madh me lloj-lloj pemësh. Në mes të kopshtit ishin dy qi-parizë të mëdhenj, afër njëri tjetrit, me degë të gërshetuara. Kushedi që kur, lart në mes të degëve, dikush kish bërë një si krevat ku mund të shtrihej lirisht një njeri. Edhe sikur të vije nga poshtë, krevatin nuk mund ta dalloje, se nuk të linin degët e dendura. Atë krevat e dinte vetëm gjyshja, nëna e Pirros dhe Pirrua vetë. Ndofta edhe ndonjë tjetër. Me siguri, ai që e kish ndër-tuar. Strofkë më të mirë për t'u fshehur nuk



gjeje. Në dhjetorin e 1924-ës, këtu ish fshehur për disa ditë rresht babai i Pirros.

U ngjitën të tre në qipariz dhe u shtrinë në krevat. Qëndruan të heshtur për pak kohë, pastaj Pirrua tha:

— E dini, për mëmën më vjen shumë keq, po asaj nuk kanë çfarë t'i bëjnë se është grua. Ja, do ta internojnë ca kohë dhe pastaj do ta lirojnë. Kështu më tha edhe xhaxhi doktori.

— Ashtu është...

— Unë kam shumë frikë për mësuesin...

— Thua ta vrasin?



— Edhe mund ta vrasin. Toger Boketi ka qënë njeri i madh shumë. Me siguri dyshojnë mos e ka vrrarë mësuesi, prandaj edhe e kapën.

— Mirë thua.

— Po çfarë të bëjmë?

— Duhet ta ndihmojmë.

Heshtën pak. Pirrua e theu heshtjen:

— E dini ç'them unë?

— Çfarë?

— Do t'jua them tani. Po veç nesh nuk duhet ta marrë vesh asnjë njeri tjetër. Mirë?

— Mirë.

— Hajde të betohemi të tre.

Pirrua u ngrit gjunjazi dhe shtriu dorën. Ashtu bënë edhe të tjerët. Pastaj Pirrua tha:

— Betohemi për jetën e mësuesit tonë të dashur, se nuk do të kursejmë asgjë dhe do të luftojmë kundër fashizmit si mësuesi ynë.

Të tre bashkë e përsëritën edhe një herë betimin.

\* \* \*

**T**ri hie u afruan në muret e shkollës. Ishin tre fëmijë. Të tre kishin vënë maska dhe xhaketat i kishin kthyer së prapthi.

Nata ish e errët dhe ata mezi dalloheshin. Ish shumë vështirë për t'i njohur, edhe ditë të qe.

Më i gjati shkoi afër murit, u mbështet mirë, përkuli kurrizin dhe vuri duart në gjunjë. Sipër tij hypi i dyti dhe u kap pas parmakut të dritares së katit të dytë. U dëgjua një krisëm e thatë. I



dyti kish thyer xhamin me gur. Copat ranë në rrugën e shtruar me kalldrëm, duke bërë zhurmë.

Më i shkurtri vinte e vinte poshtë e përpjetë. Bënte roje.

I dyti futi dorën në xhamin e thyer, kapi dorezën, e rrotulloi me vështirësi dhe dritarja u hap. Ai hypi mbi parmak dhe pastaj u fut brenda në klasë. U var në dritare dhe i dha dorën të parit. I pari kapi dorën e shokut, mbështeti këmbët në mur dhe hypi në dritare. I treti u hodhi litarin që poshtë.

Brënda në shkollë u dëgjua një zhurmë. U shqye një dërrasë, pastaj u bë heshtje.

Në parmakun e dritares u vendos një arkë. I pari me të dytin e lidhën me litar dhe e varën poshtë. I treti e zgjidhi, e tërhoqi zvarë dhe e vendosi rrëzë murit të xhamisë.

Në dritare u duk edhe një arkë, pastaj një tjetër e një tjetër. Brenda gjysmë ore zbritën nga dritarja njëzet e pesë-tridhjetë arka.

Ata që ishin lart nisën të zbresin. Ai që ish poshtë i pyeti:

— Nuk kish më?

— E boshatisëm krejt depon. Nuk ka më asnjë arkë.

I pari rrëmbeu një arkë dhe tha:

— Tani, o burra, t'i çojmë në oborrin e xhamisë!

Ai që kish qëndruar poshtë si roje, uli kurrizin. I pari i vuri arkën në kurriz. Pastaj uli vetë kurrizin dhe shoku i vuri një arkë. I dyti mori përpara duarve arkën e tretë. U nisën drejt oborrit të xhamisë, që nuk ish shumë larg. I lanë aty



arkat dhe u kthyen prapë poshtë penxheres. U ngarkuan përsëri e përsëri gjersa i çuan të gjitha arkat pranë xhamisë.

Në oborrin e xhamisë kish një pus të madh e të thellë. Të tre tok kapnin arkat dhe i hidhnin brenda. Dëgjohej një zhurmë e mbytur. Pas pak të gjitha arkat ishin hedhur në pus.

U larguan nga oborri i xhamisë dhe morën rrugën. I treti tha:

— E ngjitët letrën në derën e shkollës?

— Harruam fare!

U kthyen të tre, shkuan tek dera dhe ngjitën një letër të madhe, të bardhë, shkruar me bojë të



kuqe. Pastaj u shpërndanë nëpër rrugica të ndryshme.

Nata ish e qetë.

Të tre shokët u futën nëpër shtëpitë e tyre pa u ndjerë dhe ranë të flenë, po gjumi nuk i zinte. Ata ishin të gëzuar se aksioni i tyre i parë kish dalë me sukses.

Po kush ishin ata të tre?

Besoj se kuptohet lehtë: ishin ata që bënë betimin në krevatin e ndërtuar në mes të dy qiparizëve. Ishin Pirrua, Agimi dhe Zihniu, tre shokët e ngushtë, që kishin vendosur të luftonin kundër fashizmit.

Në mëngjes, të gjithë nxënësit dhe mësuesit e shkollës panë në derë një letër të madhe, të bardhë, shkruar me bojë të kuqe. Në të lexohej:

**«POSHTË FASHIZMI ME GJITHË GALETA!  
LIRONI MËSUESIN!»**

Në mes të letrës skuqte një yll. Poshtë tij ishin vizatuar një drapër e një çekan dhe katër gërma: V.F. — L. P.

V

— Mbahuni shokë! Unë do të kthehem prapë!

**H**im Mehmeti kish tri ditë që mbahej në burgun e komandës të karabinierisë së fshatit. Veç Luogotitos dhe një civili, që e pyeste dhe mbante shënime, nuk kish të drejtë ta takonte asnjë tjetër. Bile as nënprefekti, Hysni Lepeni.

Mësuesi rrinte gjithë ditën mbi një arkë, pastaj ngrihej e sillej rreth dhomës së ngushtë e të errët.

E pyesnin vazhdimisht, që nga mëngjesi në mbrëmje. Nganjëherë edhe natën. Himi, herë përgjigjej, herë jo. Si të ishte pyetja. Kur e pyesnin për gjëra të përgjithëshme, përgjigjej pa e ngritur kokën, me përtim, ndërsa kur e pyesnin për vrasjen e Boketit, heshte dhe bënte sikur nuk dinte gjë fare.


Luogotitua e pyeti:

— Pse nuk tregon?

— Se nuk di gjë...

— Ashtu?! Nuk është as rasti dhe as vendi që





të bësh shaka... Me gojë thua se nuk ke marrë pjesë në vrasjen e tenente Boketit, po plaga në këmbë tregon të kundërtën. Kujt t'i besojmë, gojës apo plagës?

— Kujt të doni... Po mendoj se i duhet besuar njeriut. Plaga s'ka të bëjë fare me atë çështje.

— Po më bën të qesh... Ti je mësues dhe u tregon përralla nxënësve. Mos më pandeh dhe mua nxënës e do që të t'i besoj përrallat që thua? Do të të tregoj një përrallë shqiptare. Ndofta e di, po nuk është keq të ta përsëris. Përsëritja është mëma e dijes... Apo jo?

— ...

— Thonë se një herë njërit i kërkuan gomarin. Ai tha: — Nuk e kam këtu. Mirëpo në atë çast gomari pëlliti në grazhd. I thanë të zotit përsëri: — Ja ku e ke gomarin, pse thua nuk e kam. I zoti u përgjegj: — Cilin besoni ju, gomarin që është një kafshë apo mua që jam burrë?...

Luogotitua heshti pak, pastaj shtoi:

— Unë besoj gomarin, jo të zotin.

— Besoni cilin të doni. Unë kaq kisha për të thënë.

Himi me Luogotiton njiheshin prej shumë kohësh. Një vit më parë, kur Himin deshën ta transferonin në qytet, ish pikërisht ky Luogotito që kish dhënë urdhër për të mos e lëvizur nga fshati. Luogotitua e kish thirrur në zyrën e tij dhe i kish thënë shkurt e qartë:

— Ju mbajmë në fshat që të rrini urtë. Nuk i bihet murit me kokë, sinjor profesore...<sup>1)</sup>

---

1) Zoti profesor!



— Unë jam një mësues i thjeshtë.

— Një mësues i kuq di më tepër se një profesor veç...

Mësuesi kish buzëqeshur.

Luogotitua kish vazhduar.

— Mos u mundoni kot. Kini të bëni me një mur të fortë.

Tani që po e pyeste, Himi iu kujtuan këto fjalë dhe, si e shikoi me bisht të syrit Luogotiton, tha:

— Një vit më parë më thatë se kishim të bënim me një mur shumë të fortë.

— Po, më kujtohet...

— Një gur, nga muri i fortë, u rrëzua para ca ditësh, prandaj edhe u munduat gjer këtu, si-njor Luogotito...

Luogotitua e qëlloi me kamxhik në fytyrë, po mësuesi as lëvizi nga vëndi e as tha gjë.

Koloneli kish dëshirë ta shtronte në dru mësuesin e ta bënte për ujë të ftohtë. Po burgu i karabinierisë nuk ish vend i përshtatshëm. Po ta rrihte, mësuesi do të bërtiste dhe do ta dëgjonte gjithë fshati. Kështu mund të ndodhte ndonjë e papritur dhe kjo nuk i pëlqente aspak Luogotitos. Prandaj dha urdhër që të bëheshin përgatitjet. Të nesërmen mësuesin do ta nisinin për në Vlorë.

Himi donte të takonte patjetër ndonjerin nga fshatarët. Donte t'i thoshte diçka të rëndësishme. Po si e qysh? Mendoj e mendoj gjatë dhe pastaj e gjeti rrugëdaljen. Nisi t'i bjerë derës së burgut me forcë.

Karabinieri, që bënte roje jashtë, e pyeti:

— Ç'farë ke?

— Dua nëntoger Bonfanten.

E lajmëruan dhe pas pak nëntogeri u fut në dhomën ku ish mbyllur mësuesi.

— Vendosët të tregoni?

— Desha të më mjekojnë plagën.

— Fatkeqësisht nuk kemi as doktor dhe as infermier. Duroni gjersa të shkoni në Vlorë...

Bonfantja fliste me ironi.

Mësuesi tha:

— Nuk kini ju, po ka fshati. Është një praktikant që i thonë doktor Zota. Ju e njihni mirë se ka mjekuar edhe një karabinier tuajin, kur e kafshoi nepërka.

— Aaa, po... E mbaj mend. Do ta thërresim.

Në drekë Bonfantja dërgoi një karabinier në shtëpinë e doktor Zotës dhe e urdhëroi që të vinte të mjekonte plagën e mësuesit Him Mehmeti. Doktor i shkoi, po nuk shkëmbeu dot asnjë fjalë me të. Kur po i mjekonte plagën, mbi kokë i rrinin Luogotitua, nëntoger Klaudioja dhe dy karabinierë.

Megjithatë Himi, kur po i mjekonte plagën, diçka lëshoi brenda në trastën e ilaçeve të doktor Zotës. Doktor i pa dhe i shkeli syrin.

Kur do të largohej, doktor i tha:

— Plagën e ke shumë mirë. Pothuajse është mbyllur.

Himi iu përgjegj:

— Faleminderit.

— Dhe tani lamtumirë. U takofshim shëndoshë.

Doktori i shtrëngoi dorën dhe doli. Luogotitua buzëqeshi dhe i tha nëntogërit:



— Shpreson ta takojë doktori...

— Do ta takojë në botën tjetër!, — qeshi nëntogeri.

\* \* \*

**K**ur doli nga karabinieria, doktor Zota vrapoi për në shtëpi dhe hapi trastën e ilaçeve. Si kontrolloi mirë e mirë, së fundi gjeti një copë letrë të palosur e të stërpalosur, në formën e një fije shkrepseje. Mësuesi e kish mbajtur në mes të gishtërinjve të dorës dhe e kish lëshuar në çastin e duhur. Asnjë nuk e kish vënë re, përveç doktorit.

Doktor Zota e hapi letrën me kujdes dhe e lexoi disa herë. Mësuesi kish shkruar pak fjalë.

«Tek ∞ ∞ K. Iki. Shokët. Kaciqërve»

Doktori e grisi letrën dhe filloi të mendojë se ç'donte të thoshte Himi me këto fjalë e me këtë shenjë. Si mendoi e mendoi për një kohë të gjatë, më në fund e zbërtheu enigmën. Mësuesi kish dashur të thoshte:

«Tek kthesa e Kondufit do të iki. Lajmëro shokët në Shpellën e Kecërve».

Doktor Zota doli në rrugë dhe u var poshtë xhadesë, në një monopat të ngushtë. Pirron e gjeti kur po dilte nga shtëpia.

— Ty po të kërkoja, Pirro. Sa mirë që të gjeta!

— More ndonjë lajm për nënën?

— Jo...

— Atëhere ke ndonjë lajm nga mësuesi!

— Po... Ku të futemi që të flasim pak?

— Ja, këtu, në kopshtin e gjyshes.

U futën në kopësht dhe u ulën prapa një ferre të madhe.

— Pirro. Shkova në burg dhe i ndërrova plagën mësuesit. Më kërkoi vetë dhe më thirrën. Më tha se ka vendosur të hidhet nga makina në kthesën e Kondufit.

— Ashtu?

— Po. Veç kërkon që shokët ta ndihmojnë me çdo kusht. Si e qysh e dinë ata vetë.

— Sa mirë! Po ku ta dinë ata se çfarë do të bëjë mësuesi?

— Do t'i lajmërojmë ne.

— I lajmërove?

— Po të shkoj vetë atje ku janë partizanët, italjanët mund të dyshojnë.

— Shkoj unë!

— Atë mendova edhe vetë. Do të marrësh një trastë me ndërresa dhe pak bukë e do të nisesh për në Malide. Po të të ndalojnë karabinierët, thuaju se po shkon tek halla jote... Si të dalësh në hundën e Dubës, mbathja përroit e përroit dhe dil në Shpellën e Kecërve. Atje në ndonjë guvë, janë të fshehur partizanët. Këndo ose thirru... bëj ashtu si të shohësh...


— Mirë.

— Kur t'i takosh, thuaju se Himi ka vendosur të hidhet nga makina tek kthesa e Kondufit. Ata duhet ta ndihmojnë patjetër.

— Do t'u them.

— Ke qënë ndonjëherë në Shpellën e Kecërve?





— Kam qënë me mëmën  
kur lante qilimët në dërstilë.

— Nisu pra që tani.

U ndanë.

Pas dhjetë minutash, me  
trastë në krah e me shkop në  
dorë, Pirrua doli në rrugën që  
të çonte në Malide. Ecte mono-  
pateve e rrëzave që të mos ta-  
konte njeri. Kur doli në Dubë,  
ja mbathi përroit e përroit me  
një frymë. Pas një ore e gjys-

më arriti në Shpellën e Kecërve.

U suall tutje tëhu duke fishkëllyer një këngë

partizane. Ndërsa ish duke kënduar, dikush doli si nga dheu dhe e kapi përkrahësh. Pirrua ktheu kokën dhe pa Xhel Bregun e parruar që po i buzëqeshte.

— Mirëseerdhe, o partizan i vogël. Ç'e mirë të solli?

— Vdekje Fashizmit!, — tha Pirrua dhe ndërroi me grusht.

— Liri Popullit!, — iu përgjegjën tre vetë bashkë dhe pastaj e përqaftuan me radhë.

Xhela e pyeti:

— Ç'ka ngjarë?

U ulën të katër këmbëkryq dhe Pirrua u tregoi për gjithçka, që kish ndodhur qysh nga dita që u vra togër Boketi e gjer para dy orësh, kur u largua nga fshati.

Pasi qëndruan gjatë dhe e pyetën për shumë gjëra, Xhel Bregu me dy partizanët e tjerë e përqaftuan përsëri Pirron dhe e përcollën gjer në një farë vendi. Kur po ndaheshin, Xhela i tha:

— I thua doktor Zotës që të mos bëhet merak. Po të ketë mundësi le ta lajmërojë edhe Himin se ne do ta ndihmojmë tek kthesa e Kondufit. Qysh sonte do të jemi atje.

Pirrua mori rrugën për t'u kthyer në fshat, pasi u përshëndet me të tre. Zemra i rrihte fort dhe mendonte...

...Mësuesi do të shpëtojë! Sa mirë... Po mëma ime ku do të jetë vallë? A do ta shoh dot më? Mëmë! Mëmë! Sa mall e sa dëshirë kam të të shoh në këto çaste! S'ka shumë ditë që jemi ndarë dhe më duket se kanë kaluar vite!...

Mësuesi do të shpëtojë... Pastaj, kushedi, ai



bashkë me shokët e tij do ta shpëtojnë edhe mëmën time...

Duke bluar këto mendime, u fut në shtëpinë e doktor Zotës dhe i tregoi fill e për pe për takimin me partizanët.

Kur mbaroi së treguari, doktori e ngriti lart gjithë gëzim dhe e puthi në ballë.

— Tani shko, se t'u bë vonë, o trim i vogël! Po të pret gjyshja.

Kur u largua Pirrua, doktori po vriste mendjen si të lajmëronte Himin... Të shkonte prapë në karabinieri për t'i ndërruar plagën, do të dyshonin. Po edhe sikur të mos dyshonin, me siguri nuk do ta linin ta takonte të plagosurin. Edhe sikur ta takonte, nuk mund t'i thoshte gjë, pasi do t'i rrinin mbi kokë si xhebrailë... As letër nuk mund t'i jipte. Ishte një punë fort e ngatërruar.

Vendosi t'i shkelte syrin kur ta nisinin për në Vlorë. Prandaj vazhdimisht, do të rrinte tek sheshi përpara kafeneve. Veç kish frikë: po sikur ta nisinin natën Himin? Si të bënte atëhere?

Po të takonte në xhade, do të kollitej tri herë dhe do t'i thërriste: «Lamtumirë!» Me siguri Himi do ta njihte nga zëri.

\* \* \*

**N**ë mëngjes herët, mësuesin e nxorën nga burgu i karabinierisë me duar të lidhura përpara. Karabinierët e futën përnjëherësh në mes. Nisën të zbresin nëpër rrugët e tatëpjeta, të shtruara me kalldrëm.

Nëpër dritaret e shtëpive kishin dalë njerëzit dhe shikonin. Dikush përshëndeste me dorë, dikush gante dhe mundohej të fshinte lotët. Ndonjeri i thërriste me emër mësuesit. Ai i shikonte dhe i përshëndeste me kokë. Disa herë edhe foli:

— Mbahuni, shokë, unë do të kthehem prapë!

Karabinierët i thërrisnin që të heshte.

Fëmijët e ndiqnin nga prapa. Karabinierët i shtynin me qytat e pushkëve, po fëmijët nuk donin të largoheshin.

Në mes të kafeneve, përpara dyqanit të Kasëm Sharrës, kish ndaluar një kamion. Pak më tej kish ndaluar një veturë.

Ca karabinierë hypën në karrocerinë e kamionit dhe zunë vënd afër kabinës së shoferit. Pastaj hypën mësuesin. E vendosën në mes dhe u ulën këmbëkryq. Hypën edhe karabinierët e tjerë. Përpara në kabinë hypën dy oficerë dhe shoferi.

Në sheshin para dyqaneve po sillej doktor Zota. Kur do ta hypnin Himin në makinë, doktori u kollit tri herë.

Mësuesi ktheu kokën dhe buzëqeshi. Doktor i shkeli syrin gjithë kuptim dhe u nis për t'u futur në kafene. Himi i tundi kokën dhe diçka desh të thoshte. U dëgjuan vetëm fjalët:

— U takofshim...

Fjalët e tjera nuk u dëgjuan. Një karabinier ja mbylli gojën me pëllëmbë.

Kamioni ish gati për t'u nisur. Pritej vetëm urdhëri i Luogotitos.

Luogotitua u fut në veturë dhe u dha urdhër



të niseshin. Vetura do të shkonte përpara dhe kamioni pas.

Kamioni eci nja tre katër kilometra, pastaj e ngadalësoi shpejtësinë për të marrë një kthesë të fortë e të rrezikshme. Kjo ish kthesa e Kondufit. Ajo nga sipër kish një mur të vjetër e aty këtu të rrëzuar. Nga poshtë kish një greminë të thellë me shkëmbinj të mprehtë. Sa e sa shoferë kishin gjetur vdekjen në këtë kthesë! Rruga ish shumë e ngushtë. Duhej ecur me kujdes të madh. Shoferit i dridheshin duart nga frika.

Kur kamioni ish në mes të kthesës, u dëgjuan të shtëna pushkësh.

— Doktor i paska lajmëruar shokët — tha me vete Himi dhe u shtri barkas.

Makinës iu shpuan gozat e para dhe u përplas në mur e qëndroi në vend. Shoferi ulëriti dhe koka iu var mbi timon. Një oficer e tundi, po shoferi kish vdekur në vend nga një plumb.

Njëri tha:

— Xhuzepja të ruajë të arrestuarin!

Karabinierët dhe oficerët zbritën me të shpejtë dhe nisën të shtrihen nëpër kanalën e rrugës, përpara makinës. Dikush u rrëzua si thes në tokë. Një tjetër thirri ashtu siç kishin zakon italianët:

— Mama mia!)

Filloi një luftë e vërtetë. Partizanët mundoheshin të shtinin sa më rrallë dhe kishin kujdes që plumbat të mos zinin në karroceri.


Himi mbeti vetëm me një karabinier në makinë. Kur plasën dy bomba dhe u bë tym e flakë.

---

1) Nëna ime!

mësuesi i dha një shkelm në kokë karabinierit Ai u bë njësh me dhogat dhe humbi ndjenjat. Nisi t'i dalë gjak, i cili i mbuloi fytyrën.

Duke u munduar, Himi u hodh nga makina dhe ra barkas, afër kanalit. Në film mendoi të bashkohej me shokët. Mirëpo një gjë e tillë ish e pamundur. Lart nuk ngjitej dot se muri ish shumë i lartë. Poshtë shtrihet gremina. Përpara nuk ecte dot, se ishin karabinierët dhe mund të hante ndonjë plumb kokës. Vendosi të tërhiqet prapa.





Lufta vazhdonte.

Himi u zvarris gjer tek mulliri i prishur, pra-pa kthesës, dhe ua mbathi këmbëve poshtë drejt shtëpive në fund të fshatit. Plagën nuk e ndjente fare. Eci e eci-dhe pastaj u zhduk në mes të kop-shteve.

Karabinieri me kokë të çarë u përmend dhe pa rreth e rrotull. Mësuesin nuk e gjeti në makinë. Më mirë të zbriste poshtë se të rrinte aty. Po ta gjenin vetëm do t'i kërkonin llogari për mësuesin. Zbriti nga makina dhe bëri përpara. Një plumb e zuri në gjoks dhe karabinieri u shtri në mes të xhadesë.

Kur panë Himin që zbriti nga makina dhe u largua, partizanët hodhën nja katër bomba, që e bënë vendin tym e flakë, dhe nisën të tërhiqen duke shtënë rrallë e më rrallë.

Mësuesi kish shpëtuar! Tani mund të iknin të qetë.

Ndërsa partizanët humbën nëpër pyll dhe nuk po shtinin më, në kthesë u duk vetura. Luogotitua e kish ndaluar makinën kur kish dëgjuar të shtënat dhe me revolver në dorë ish fshehur pas një shkëmbi. Kur mbaruan të shtënat, u nis dhe ja ku i doli përpara një fushë e vogël beteje: dy karabinierë dhe shoferi tre, të vrarë, disa të plagosur dhe makina në flakë. Karabinierët e tjerë ishin shtrirë nëpër kanale, të verdhë në fytyrë si kufoma dhe nuk lëviznin që andej. U ngritën vetëm kur panë Luogotiton.

Ai bërtiti:

— Po mësuesin ku e kini?

Bonfantja u përgjegj:

— Po e ruante Xhuzepja.

— Ç'Xhuzepe?! Xhuzepja ja ku është... foli dikush duke treguar kufomën e një karabinieri.

Vrapuan të gjithë në karrocerinë që po digjej. Mësuesi nuk dukej.

— Idiotë! Ju ka ikur!

Karabinierët s'dinin ku kishin kokën e tyre dhe shikonin akoma si të hutuar.

— Shpejt në ndjekje! Nga kaloi?

— Këndeje duhet të ketë kaluar. S'ka patur rrugë tjetër.

Karabinierët u lëshuan poshtë, drejt mullirit, të gjithë tok, duke përplasur këpucët me gozhdë e duke u rrëzuar.

— Nuk ka nga del, se fshati është i rrethuar!  
— thirri nga prapa Luogotitua.

Në këtë çast, në xhade po vinin me një frymë dhjetra karabinierë. Ata kishin dëgjuar krismat dhe nxituan që të ndihmonin shokët.

Luogotitua i la sa u afruan dhe u tha:

— Shpejt të kapni mësuesin. Duhet të jetë brenda në fshat!

Karabinierët vrapuan pas të tjerëve, drejt shtëpive në fund të fshatit.

Bonfantja iu afrua Luogotitos dhe me zi i tha dy fjalë:

— Po sikur të kishim ndjekur ata që na qëlluan, nuk do të ish më mirë?

— Ti nuk ruajte dot këtë që ish i plagosur, i lidhur dhe pa armë, jo të kapësh ata! Porco!<sup>1)</sup> Do të dalësh në gjyqin ushtarak! More vesh?

Bonfantja nuk foli më dhe nisi të ecë pas Luogotitos që shkrofëtinte si bishë e plagosur.

---

1) Derr!



Luogotitua arriti në sheshin para kafeneve, ku ishin mbledhur shumë vetë, pasi kishin dëgjuar të shtënat. Në mes të tyre ishte dhe doktor Zota. Ai qeshte nën mustaqe. Me sa dukej nga fytyrat e italianëve, mësuesi kish ikur. E kishin shpëtuar shokët.

Luogotitua u afrua dhe bërtiti sikur ta kish kafshuar gjarpëri:

— Ose do të gjendet mësuesi, ose do të djeg gjithë fshatin! Morët vesh?

Asnjë nuk përgjigjej. Atëhere Luogotitua u xhindos më keq dhe thirri:

— Do t'ju shkoj të gjithëve në plumb! Siete tuti partixhiani! <sup>1)</sup>

Fëmijët, që ishin mbledhur në shesh, ja mba-thën vrapit. Burrat që rrinin para kafeneve dhe luanin trishetë, u ngritën dhe u futën brënda.

E mori vesh gjithë fshati se mësuesi u kish ikur italianëve. Ky lajm, nëpërmjet telit të telefonave, arriti gjer në Vlorë e në Tiranë. E mësoi edhe ministri i punëve të brëndëshme.

Afër mbrëmjes arritën forca të reja në fshat. U ndalua lëvizja dhe filloi kontrolli shtëpi më shtëpi.

Natën, me fenerë në duar, karabinierët kontrolluan gjatë. Edhe të nesërmen gjithë ditën vazhdoi kontrolli, po mësuesi nuk u gjet dot.

Luogotitua bërtiste:

— Mësuesi është brënda në fshat. Nuk ka nga të dalë, se e kemi rrethuar vendin. Të gjendet, gjallë a vdekur!

---

1) Jini të gjithë partizanë!

Ai doli vetë dhe kontrollloi çdo skutë, hypi nëpër çatira shtëpish e xhamiash, u fut nëpër kopshte e oborre, bile edhe në qymezat e pulave. Mullarët me bar i kositi me mitraloz. Si e pa që duke kërkuar nuk gjente dot gjë, dha urdhër që të mbli-dheshin gjithë burrat e fshatit në xhami.

Burrave u foli shumë shkurt vetë Luogotitua:

— Do ta djeg gjithë fshatin! Do të vras me dorën time gjersa të lodhem! Dorëzoni mësuesin!

Duke shtyrë me bërryla, në krye të burrave





doli doktor Zota. Iu afrua Luogotitos dhe i tha:

— I nderti kolonel, pse na e kërkoni neve atë që ju e patët dhe nuk e mbajtët dot?

Luogotitua shikoi me bisht të syrit nënprefektin Hysni Lepeni dhe i tha diçka. Nënprefekti iu drejtua doktorit:

—Ty nuk të foli njeri. Do të bësh më mirë të heshtësh.

— Këtu nuk fola për veten time po për të gjithë.

Doktor Zota ish nxehur dhe po e përplaste bastunin në pllakat e sallës së madhe të xhamisë. Luogotitua dha urdhër ta nxjerrin jashtë doktorin. Ai kundërshtoi dhe tha diçka. Karabinierët e nxorën me forcë. Doktorin u ul diku në një gur dhe priti.

Fshatarët filluan të murmurisnin:

— Le ta zënë vetë po mundën!

— Ç'ua bëri paq mësuesi!

Nëntoger Klaudio Bonfante, i nxehur, kapi një plak që e kish afër dhe me forcë i mori dorën e djathtë në duart e veta. Në mes të gishtërinjve i futi nga një fishek, pastaj ja shtrëngoi edhe më fort. Plakut i ra të fikët dhe u shtri në mes të xhamisë.

Një oficer me syza po u binte me kamxhik disa fshatarëve përnjëherë. I qëllonte ku të mundte: në kokë, në fytyrë, në supe e kudo, dhe thërriste:

— Tregoni ku ka shkuar partizani.

Një burrë i shëndoshë, andej nga fundi, u përgjegj:

— Nuk e dimë. Gjejëni vetë!

Luogotitua bërtiti:

— Ashtu?! Dale se ta tregoj unë ty!

Të gjithë kthyen kokat nga burri që kishte folur. Ishte Kadri Bata, një fshatar që punonte në rrugë si punëtor krahu.

Karabinierët e sollën Kadrinë në mes të sallës. Luogotitua dha urdhër t'i lidhnin duar e këmbë dhe ta shtrinin për tokë. Një karabinier i vuri këpucën alpine në zverk, ndërsa një tjetër po e mbante për këmbësh. Një i tretë diku gjeti një hu gardhi dhe filloi ta qëllonte në kurriz. Kadriu shtërngohej dhe mundohej të duronte dhimbjet pa bërtitur. Në sallë prapë u dëgjua murmuritja e burrave. Luogotitua thirri:

— Trego, se do të vdesësh në duart e mia!

— Nuk di asgjë! Bishë!

Burrat filluan ta ngushtojnë rrethin rrotull Kadriut. Luogotitua hapi sytë nga habia.

Në këtë çast xhamat e xhamisë, nga të katër anët, nisën të bëhen copë e thërrime. Nga jashtë po qëllonin me gurë. Rreth e rrotull xhamisë fëmijët zunë të bërtisnin. Më tej nisi të bjerë një kabanë e madhe. Nga të gjitha rrugicat filluan të derdhen gratë drejt xhamisë, si lumi që del jashtë shtratit. Ato bërtisnin e çirreshin dhe tundnin nëpër duar sëpata, kosore dhe hunj të mëdhenj. Oborri u mbush plot e përplot. Gratë bënin përpara me sa fuqi kishin. Karabinierët i shtynin me bajoneta. Luogotitua doli jashtë të shikonte çfarë po ndodhte. Kur pa gratë si të ndërkyera e plot urrejtje, desh të futej brenda. Gratë nisën të bërtasin me të madhe.



— Duam djemtë!

— Duam burrat!

Dhe u shtynë drejt dyerve. Karabinierët u shtrydhën në muret e xhamisë. Disa gra arritën të futen brenda. Burrat vunë në mes karabinierët dhe qenë gati t'u hidheshin në grykë. Luogotiuta, për të shpëtuar nga ndonjë e papritur, dha urdhër që të liroheshin burrat. Të dy dyert e xhamisë u hapën dhe burrat vërshuan në oborr. Fëmijët u hodhën në krahët e tyre dhe i push-tonin fort.

Pirrua po përqafonte doktor Zotën.

## VI

— Lufta për liri nuk pyet për moshë. Të mëdhenj e të vegjël janë një: luftëtarë! —

**S**i u larguan të gjithë nga xhamia, Pirrua u nis për te gjyshja. Ecte me duar në xhepa dhe mendonte... Në fillim mendoi për nënën, që ja internuan në Burrel, pastaj për mësuesin.

Sa shpejt që kish ikur mësuesi! Ai takimi me partizanët në Shpellën e Kecërve, ditën e shkuar, nuk kish shkuar kot. Partizanët kishin bërë pritën dhe mësuesi shpëtoi.

Po edhe Pirrua me shokë nuk qëndruan duarlidhur. Kur burrat i kishin mbledhur brënda në xhami, ata kishin thyer xhamet, kishin bërtitur e kishin bërë gjurulldi dhe kështu ndihmuan fshatin. Brënda pak ditësh, bashkë me shokët, të udhëhequr nga Shefqeti, ai shoku i rinisë, që merrej me pionierët, kishin bërë disa aksione.

Mësuesi i tij kish shpëtuar. Sa i zoti, sa i fortë e sa i shkathët ishte partizani Him Mehmeti! U iku gjithë atyre italianëve. Dhe kur? Mu në mes të ditës, në mes të plumbave e të bombave. Dhe ish i lidhur me zinxhirë në duar! Dhe ish i plagosur në këmbë! Sikur të mos i kish duart me zinxhirë e sikur të mos ish i plagosur, mësuesi partizan mund të bënte çudira!



Po tani ku ish? Ku qe fshehur? A kish gjetur ndonjë vend të mirë? Çfarë bënte? Me çfarë ushqehet? Po duart, akoma i kish të lidhura, apo i kish zgjidhur?... E si mund t'i zgjidhte vetë?

Me këto mendime arriti Pirrua në shtëpinë e gjyshes. Ajo po e priste te dera. E puthi, e futi brënda dhe i shtroi për të ngrënë. Pirrua hante nga një kafshatë dhe mendonte për nënën. për mësuesin... A kishin bukë për të ngrënë edhe ata? Po sikur të mos kishin?

E la bukën përgjysëm dhe doli jashtë. Gjyshja e ndoqi nga pas dhe i thirri:

— Pirro, mos u largo të keqen. Kam një fjalë për të të thënë.

— Nuk iki, jo. Këtu jam.

U fut në kopsht, erdhi rrotull nja dy-tri herë dhe pastaj u afrua tek qiparizët. U habit kur pa se shkalla prej litari nuk ish e varur në qipariz, si gjithmonë. Kush ta kish hequr? Duke mbështetur kurrizin në trungun e njerit qipariz e duke vënë këmbët në trungun e tjetrit, filloi të ngjitej lart. Kur arriti te degët, e drejtoi trupin dhe nisi të ngjitet si ketër me të shpejtë. Degët e qiparizëve ishin gërshetuar si shkallë dhe mund të ngjiteshe pa vështirësi gjer tek shtrati me thupra e me kashtë.

Dhe një degë e Pirrua do të shtrihej në shtrat, por...

Dy këmbë që vareshin poshtë shtratit e bënë të ndalojë. Zemra i rrahu fort dhe nëpër trup i kaluan mornica. U mbajt fort pas degëve që të mos binte. Shikoi edhe më mirë, duke u zgjatur në majat e gishtërinjve e duke marrë frymë



me ngadalë dhe, përnjëherësh, njohu mësuesin partizan. Njohu Him Mehmetin. Nga gëzimi desh thirri me të madhe, po kur pa që mësuesi flinte, u qetësua dhe u ngjit lart, pa u ndjerë fare.

Ja pra kush e kish hequr shkallën prej litari. . . .

Pirrua u ul afër këmbëve të mësuesit dhe po e shikonte e po e shikonte pa ja hequr sytë. E pa në fytyrë, në trup dhe pastaj e ndaloi vështrimin tek duart. Ato ishin të lidhura me një kllapë hekuri, një gisht të trashë, dhe me një kyçenicë. Kyçenica ish e verdhë dhe shkëlqente. Hekuri ish i errët dhe nxinte.



U afrua edhe më, u përkul mbi trupin e mësuesit dhe nisi t'i përkëdhelë duart e lidhura.

Sikur t'ja zgjidhte duart si me magji, pa u ndjerë!

Një gjë e tillë ndodh vetëm nëpër përralla...

Për një çast mendoi sa vështirë do ta kish patur mësuesi për të hypur gjer atje lart, me duar të lidhura. Pastaj mendoi ndryshe. Mësuesi që u iku gjithë atyre karabinierëve, mund të ngjitej gjer në qiell, jo vetëm në këta qiparizë!

Po ku e dinte ai se në mes të këtyre dy qiparizëve kish një krevat të thurur me degë e me kashtë, ku mund të shtrihej e të flinte i qetë, se nuk e gjente dot njeri? Mos vallë kish hypur edhe herë të tjera? Apo ja kish treguar ndokush?

Mësuesi gërhati dhe lëvizti. Duke u kthyer ndeshi në këmbët e Pirros. Hapi sytë dhe u ngrit përnjëherësh gjunjazi.

— Sa më trembe!

— Ju nuk u trembët nga fashistët...

Himi vuri buzën në gaz dhe e afroi Pirron pranë vetes. Pirrua e pushtoi dhe nisi ta puthë.

— Shpëtuat, zoti mësues.

— Akoma nuk kam shpëtuar mirë.

— Këtu nuk ju gjen njeri.

— Ja ku më gjete ti.

— Unë e di këtë vend, se është kopshti i gjyshes sime.

U shtrinë të dy dhe nisën të bisedojnë. Mësuesi pyeste dhe Pirrua përgjigjej. I tregoi për takimin me partizanët në Shpellën e Kecërve, për pritën në kthesën e Kondufit, për karabi-

nierët, që iu vunë prapa, për Luogotiton që mblo-  
dhi burrat në xhami, për rrahjen e Kadriut, për  
ulërimat e grave dhe për sulmin e tyre.

— Dëgjova edhe unë të bërtitura dhe më  
shkoi mendja për keq...

— Zoti mësues...

— Shiko Pirro! Harrova të të them se këtej  
e tutje ne do të jemi shokë. Nuk dua të më  
thërresësh zoti mësues, po shoku Him. U morëm  
vesh?

— Po unë nuk jam shoku juaj. Jam i vogël...

— Kush tha se je i vogël? Ti je shok! Dhe  
një shok i mirë bile! Ti e urren fashizmin, ti e  
lufton atë.

— Ku e dini ju se e luftoj? Kush ju ka  
thënë?

— E di vetë unë...

— Mos ju ka thënë gjë njeri për galetat?

— Për cilat galeta?

— Për galetat e shkollës, shoku Him. Unë,  
Agimi dhe Zihniu jemi betuar që ta luftojmë fa-  
shizmin,

— Ju lumtë!

— Një natë morëm arkat me galeta që ndo-  
dheshin në shkollë dhe i hodhëm në pusin e  
xhamisë...

— Galetat që ju jepnin mëngjes për mëngjes  
si dhuratë nga Duçja?

— Po, ato.

— Pse i hodhët?

— Se nuk duam dhurata nga fashizmi! Ne  
shkruam në një letër të madhe: «Poshtë fashizmi  
me gjithë galeta! Lironi mësuesin!». Letrën e



ngjitëm në derën e shkollës dhe e lexuan të gjithë: nxënës e mësues. Kishim bërë edhe një drapër e një çekan.

Mësuesi e shtrëngoi Pirron pas vetes, sytë iu njomën dhe tha:

— Ti, Pirro, bashkë me shokët e ty, jeni heronj të vegjël. U ngritët në mbrojtje të mësuesit, ë? Aq shumë më dashki?

— Shumë...

— Po kush ju mësoi?

— Ju na kini mësuar, shoku Him.

— Vetëm unë?

— Na mëson edhe Shefqeti.

— Po tjetër gjë kini bërë?

— Nga burgu nuk ju lironim dot, se edhe për atë menduam.

— Shiko, shiko sa të zgjuar!

Për një çast heshtën të dy, duke shikuar njëri tjetrin. Pastaj Pirrua tha:

— Kur ishin mbledhur burrat në xhami, ne thyem xhamet e dritareve me gurë. Nuk kishim pushkë, se do ta kishim vrarë atë oficerin e gjatë, kur doli te dera dhe desh t'u fliste grave.

— Ti, Pirro, do të bëhesh trim si babai.

— Shoku Him... Ku e dinit se në mes të këtyre dy qiparizëve ka një krevat?

— Unë nuk dija gjë. Di ja vetëm se ky është kopshti i gjyshes sate.

— Dhe erdhe të fshihesh tek gjyshja?

— Jo. Kur ika nga makina dhe vrapova më të poshtë, rruga më nxori në kopsht. Gjyshja jote po mblidhte lakra aty rrotull. I thashë:

«Gjyshe e Pirros, më fshih, se po më ndjekin italianët!»

Ajo e humbi një çast, pastaj tha:

«Ti mësuës je?»

«Po unë...»

«Ku të të fut unë e shkreta?»

«Shpejt, se po vijnë!»

Nga larg, prapa nesh, dëgjoheshin hapa dhe zëra italianësh.

Gjyshja u mendua një hop, pastaj më tregoi me dorë dy qiparizët. Hodha sytë andej nga kish drejtuar dorën. Varur pashë shkallën prej litari.

Pirrua e ndërpreu:

— Atë shkallë e ka patur daja, vëllai i mëmës. Është shkallë vapori. Daja ka qënë detar...

Mësuesi vijoi:

— U afrova te qiparizët. Bashkë me mua u afrua edhe gjyshja. Ajo më tha:

«Këtu nuk të gjen dot njeri. Hypë!»

«Faleminderit, gjyshe!»

«Mos u bëj merak, se do të t'i dërgoj me Pirron të gjitha ç'do të duhen.

— Pasdite dërgoje...

— Kështu thashë dhe fillova të ngjitem nëpër shkallë. Duart e lidhura më pengonin shumë. Edhe këmba e plagosur më dhimbte pak. Mirëpo vullneti bën çudira!... Gjyshja mbante shkallën që të mos lëvizte dhe me dorën tjetër më ndihmonte që të ngjitesha. Me njëmijë mundime hypa gjer te degët e para. Isha bërë ujë në djersë. Si u çlodha pak, tërhoqa shkallën dhe pastaj, degë më degë, me këmbë e me duar, arrita lart. Gjyshja doli nga kopshti dhe tërhoqi derën e



gardhit nga pas. Unë u shtriva i kapitur. Poshtë-  
dëgjova karabinierët që nxitonin. Pastaj... pas-  
taj rashë në gjumë.

Mësuesi heshti. Pirrua iu afrua edhe më, e  
tha:

— Për ju deshi të më tregonte gjyshja që-  
parë... Ajo më tha të mos largohesha, se diçka  
do të më thoshte.

— E porosita unë të të dërgonte këtu, pas-  
dite.

— Është mirë këtu, shoku Him?

— Shumë mirë. Vend më të bukur nuk ka.  
Sheh edhe një pjesë të fshatit prej këndeje. Mjaf-  
ton të lëvizësh ndonjë degë...

— Edhe sikur një vit ta mbajnë të rrethuar  
fshatin, nuk ju gjejnë dot.

— Kush e ka ndërtuar këtë krevat në mes  
të qiparizëve, ti?

— E ka ndërtuar daja. Ai i kish shumë qef  
qiparizët dhe gjithmonë mbillte të tilla, prandaj,  
kur vdiq, gjyshja i mbolli në varr, te koka, një  
qipariz. Besoj se e kini parë...

— Po, e kam parë. Qiparizi është një dru  
shumë i bukur. E mban kokën lart, atje ku shkrep-  
pin rrufetë. Me këtë sikur do t'u thotë shkrepëti-  
mave: nuk jua kam frikën!

— Ashtu siç u thoni ju fashistëve, shoku Him.

Mësuesi e shikoi plot me dashuri dhe i tha:

— Ashtu siç u thua edhe ti me shokët e tu.  
Po. E kam me gjithë mend. Dhe mos ha-  
rro një gjë: të gjithë do ta luftojnë fashizmin. Të  
mëdhenj e të vegjël. Tani kemi një dorë të fu-

qishme që na drejton. Është Partia Komuniste. Ne jemi një popull që nuk e durojmë robërinë.

Pirrua e dëgjonte në heshtje.

— Dhe tani ti, shoku Pirro, duhet të më ndihmosh.

— Me gjithë shpirt, shoku Him.

— Së pari duhet të më sjellësh pak bukë dhe ujë.

— Që tani...

— Prit, mos u nxito. Duhet të më sjellësh edhe një limë, që të mund të më presësh kllapën prej hekuri. Ti vetë do të ma presësh, more vesh?

Pirrua sa s'fluturonte nga gëzimi! Ai do t'i zgjidhte duart mësuesit. Ai do ta bënte të lirë! Të lirë!

— Limë ka gjyshja. Unë dije punova pak me të. Po shkoj t'i sjell të gjitha.

— Prit. Kur të hysh e të dalësh në kopsht, nuk duhet të të shohin.

— E di vetë unë. Për një minutë jam këtu.

— Shiko, mos i thuaj njeriut se ku jam!

— As xhaxhi doktorit?

— Atij mund t'i thuash... Do t'i kërkosh edhe pak jodio e bandazhe.

— Po Agimit e Zihniut?

— Nuk është nevoja ta dinë. Ua thua më vonë.

Pirrua nuk priti më gjatë. Sa të hapësh e të mbyllësh sytë zbriti në kopsht. U fut në shtëpinë e gjyshes, mori pagurin, e mbushi me ujë të ftohtë, mori bukë e djathë në dollap dhe u nis të ikte. U kthye dhe pasi mori limën, e futi në xhep,



Gjyshja ish duke larë rroba prapa shtëpisë dhe nuk e pa fare.

Hyri në kopsht me nxitim, u ngjit në qipariz dhe ja vuri përpara të gjitha mësuesit. Himi theu pak bukë me vështirësi dhe e futi në gojë. Pirros i erdhi keq, e mori bukën e djathin në duar dhe nisi ta mëkojë si fëmijë. Mësuesi hante me uri dhe qeshte. Kur mbaroi së ngrëni tha:

— Falemnderit, Pirro!

Pirrua uli kokën.

— Sa nevojë kam për një cigare...!

— Do t'ju sjell unë.

— Falemnderit... Ti, shoku Pirro, këtej e tutje nuk duhet të hypësh e të zbresësh vazhdimisht në qipariz, se mund të të shohin. Do të caktojme një orar. Do të hypësh vetëm pasdite që të më presësh kllapën.

— Po ti, vetëm do të rrish?

— Vetëm. Do të më sjellësh një libër që të lexoj. Le të jetë edhe libër këndimi.

— Po bukë kush do të të sjellë?

— E kam menduar edhe atë. Do të sjellësh një litar. Çdo mëngjes e çdo darkë unë do të var litarin kur të të shoh në kopsht. Ti do t'i lidhësh ushqimet në fund të litarit në një shportë të vogël.

— Sa mirë!

— Dhe tani të fillojmë nga puna. Merre limën dhe premë kllapën këtu ku është më e hollë.

Pirrua fërkoj duart dhe kapi limën. E shtrëngoi mirë e mirë, pastaj filloi ta lëvizë mbi kllapë. Lima bënte një zhurmë që të ngjethte mishtë. Në



pak çaste mbi kllapë ishte bërë një shenjë e vogël.

Balli i Pirros u mbulua me djersë dhe duart nisën t'i dhimbnin. Po ai nuk e jepte veten. Vazhonte ta lëvizte limën shpejt e shpejt, sa para prapa. Mësuesi e kuptonte që Pirrua lodhej dhe i thosh:

— Tani pusho pak, pastaj fillo përsëri.

Po Pirrua nuk donte të pushonte. Ai kish qef që mësuesi t'i kish duart të lira një orë e më parë. Ai dëshëronte që mësuesi ta pushtonte me duart e tij të fuqishme dhe ta shtrëngonte fort, shumë fort, në gjoksin e tij të gjerë.

Tani Pirrua dhe mësuesi ishin shokë. Ata i bëri shokë lufta e përbashkët kundër fashizmit. Se lufta për liri nuk pyet për moshë! Të mëdhenj e të vegjël janë një: luftëtarë!



VII

— **Revolverin e dua për mësuesin.**  
**Eshtë shëndoshë e mirë dhe kini**  
**të fala. —**

**P**as dy ditë pune, më në fund mësuesi i kish duart të lira.

Pirrua sa s'qante nga gëzimi. Mësuesi e pushtoi me dy duart e tij të mëdha dhe e ngriti për-pjetë. Edhe Pirrua e pushtoi me krahët e tij të vegjël. E pushtoi me dashuri, ashtu siç pushton-te nënën e tij.

— Tani që i ke duart e lira, mund të ikësh, apo jo?

— Ku të shkoj?

— Tek shokët që të presin.

— **Ti vetë më ke thënë se italianët e kanë rrethuar fshatin nga të katër anët dhe kanë vënë roje në çdo vend.**

— Ti u ike kur i kishe duart të lidhura, jo tani...

— **Nuk është ashtu, Pirro... Një herë u hutuan armiqtë dhe u treguan të pakujdesshëm.**

Tani që u dogjën nga qulli, do t'i fryjnë edhe kosit.

Pirrua nuk foli.

— E di ç'dua nga ti, Pirro?

— Çfarë?

— Sikur të më gjeje ndonjë bombë e ndonjë revolver...

— Bomba gjej sa të duash! Unë me Agimin dhe Zihniun kemi mbledhur edhe bomba edhe fishekë nga ato që kanë mbetur prej luftës italo-greke.

— E çfarë i donit?

— T'ua jepnim partizanëve.

— Po ku i kini?

— I kemi fshehur në një mazgallë të xhamisë.

— Të shkosh dhe të më sjellësh disa.

— Ika!

Pirrua zuri të zbresë nëpër degë, pastaj u ngjiti prapë dhe tha:

— Besoj se tani që do t'ju sjell bombat, do të ikni...

— Për të ikur nuk është aq lehtë. Ikja duhet menduar mirë që të mos bie prapë në duart e tyre. Tani për tani këtu jam i sigurt.

Pirrua dëshëronte që mësuesi të mos ikte kurrë. Megjithatë mendonte se Himi do të ishte më i sigurt në male, atje ku kishte shokët, prandaj tha:

— Do ta vras edhe unë mendjen si mund të ikni...

— Falemnderit, Pirro... Më mirë mendo se ku mund të më gjeshe ndonjë revolver.



— Edhe për këtë do të mendoj. Tani po shkoj të të sjell bombat.

Pirrua zbriti nga qiparizët dhe hyri në rrugën që çonte në xhaminë e fshatit. Aty mori disa bomba dhe i futi në gji. Ishin gjysma të kuqe dhe gjysma të zeza. Fëmijët u thërrisnin «Balila» këtyre bombave. Me sa dinte Pirrua, ato bënin shumë zhurmë dhe tym. Bomba më të mira ishin «Bredat». Ato bënin kërdinë. Po ç'e do: vetëm një të tillë kishin gjetur... Pastaj, atëhere kur i mblodhën, Pirros me shokë u pëlqenin më tepër «Balilat» se ato qenë më të bukura..

U nis drejt shtëpisë së gjyshes. U fut në kopsht dhe pa një herë rreth e rrotull. Mësuesi po lëshonte litarin. Pirrua futi bombat në shportë. Himi e ngriti.

Pas pak Pirrua u nis për në xhade, ku luanin kalamajtë. Atje nuk ishin as Agimi e as Zihniu. Pyeti dhe i thanë se ata të dy ishin duke lojtur me top lecke në sheshin e Varoshit. Shkoi atje, u takua me ta dhe të tre tok zbritën në xhade.

— Pse na hoqe nga lodra, Pirro?



— Dua t'ju them diçka...

— Ke marrë vesh gjë për mësuesin?

— Jo, jo... Më duhet një revolver.

— E çfarë të duhet?

— Si ç'më duhet, more Zihni? Po bombat që mbledhim, po fishekët çfarë na duhen? Ja, për të luftuar fashizmin. Për këtë na duhet edhe revolveri.

— Është vështirë...

— Nuk dini të ketë njeri revolver?

— Ka patur xhaxhi Qerimi një, po mund ta ketë marrë me vete.

— Ai ka shkuar në spitalin e Vlorës, s'mund ta ketë marrë revolverin... Këtu do ta ketë fshehur.

— Unë e di ku e fsheh, po nuk mund ta marr.

Pirrua u nxeh pak:

— Do ta marrim patjetër, po të jetë atje. Na duhet!

— Si thua ti, ta vjedhim?

— Ato që merren për luftën kundër fashizmit nuk quhen të vjedhura! More vesh?

Zunë të hahen me fjalë. Pirrua ngulte këmbë që ta merrnin revolverin. Agimi nuk donte. Ai tha:

— Do ta marrim po të na tregosh kujt do t'ja japësh.

— Nuk mund t'ju tregoj. Është sekret.

— Kujt, neve nuk mund të na e thuash? Atëhere kot që jemi shokë!

Ndërhyri edhe Zihniu:



— Ti je betuar bashkë me ne dhe duhet të na tregosh.

Pirrua mendoi: Zihniu me Agimin kanë të drejtë. Po mësuesi ma ka ndaluar t'jua tregoj... U përtyp e u përtyp dhe më së fundi vendosi t'u thotë:

— Betohuni se përveç jush nuk do ta mësojë asnjë tjetër.

— Ne betohemi, po më duket se është e kotë. Jemi betuar një herë të tre tok.

— Mirë, pra. Vetëm kaq do t'ju them: revolverin e dua për mësuesin. Është shëndoshë e mirë dhe kini të fala. Mos më pyetni për gjë tjetër se nuk do t'ju them. Është sekret.

Zihniu me Agimin, edhe pse kishin dëshirë të dinin shumë gjëra të tjera rreth mësuesit, nuk e pyetën shokun e tyre. U nisën të tre për të marrë revolverin.

U sollën e u sollën rreth shtëpisë dhe kur gjetën rastin, Agimi u shkëput prej tyre e shkoi tek kasollja e bagëtive, ku Qerimi fshihte revolverin. Shokët e prisnin jashtë duke luajtur. Agimi vonoi të dalë. Pirrua u mërzit dhe i tha Zihniut të shkonte të shikonte. Dy vetë mund ta gjenin më lehtë. Kur u nis Zihniu, Agimi doli nga kasollja me vrap.

— E gjete?

— Po. E kam në gji.

Pirrua e mori, e futi nën këmishë dhe iku me vrap pa u thënë asnjë fjalë shokëve. Kur ish larguar ca, ktheu kokën dhe u tha:

— Më prisni në xhade.

Të dy shokët kishin dëshirë ta dinin ku fshi-

hej mësuesi, ta shikonin së paku nga larg. Një herë menduan ta ndiqnin Pirron nga prapa. Po kjo nuk ish një sjellje e mirë. Ndërruan mendje dhe nxituan për në xhade, ku shokët po luanin.

Mësuesi le të ishte shëndoshë e mirë, pa kishin kohë ta shikonin.



## VIII

— Pirro! Unë të kam borxh jetën, se ti më ke shpëtuar timen. —

**D**ikush trokiti në derë dhe doktori doli në oborr. Kur hapi derën, pa Pirron që rrinte pak si i ndrojtur. E ftoi të hynte brenda. E uli në një fron që tundej sa para prapa, si kolovarse. Pirrua shikonte doktorin dhe nuk fliste. Doktori e pyeti:

— E mo Pirro, je gjë i sëmurë?

— Jo...

— Po pse je i mërzitur? Për mëmën?

— Edhe për mëmën... Po ajo nuk është vetëm. Ka plot shoqe.

— Hiç mos u bëj merak për të. Do ta mbajnë ca kohë atje dhe prapë do ta lirojnë.

— Unë dëgjova se do t'i shpien në Itali...

— Nuk shpien gra atje. E di mirë unë. Pastaj kam një të njohur në Vlorë. Kemi qënë ushtarë bashkë dhe e kam shpëtuar një herë nga disa hajdutë... Do të shkoj këto ditë për ca punë dhe do ta takoj. Do t'i lutem që të interesohet për ta liruar Xhejen.

Pirrua u ngrit dhe iu afrua doktorit. I kapi duart dhe ja puthi gjithë dashuri.

Doktori e largoi:

— Nuk është nevoja, mor bir...

Pirrua u ul.

— Xhaxhi doktor... Kam ardhur për një punë.

— Folë, mos ki turp.

Pirrua iu afrua dhe i tha në vesh:

— Unë e di ku është fshehur mësuesi.

Doktori brofi në këmbë:

— Vërtet?!

— Po.

— Avash, se mos të dëgjojnë.

Pirrua nisi të flasë me zë të ulët dhe ngadalë, sikur i peshonte fjalët që thosh.

— I shpie ushqime, i kam zgjidhur duart, i kam gjetur edhe bomba e revolver, tok me shokët e mi.

— Po me shëndet si është?

— Shumë mirë. Edhe plagën mirë e ka.

— Po ku është fshehur?

— Tek qiparizët, në kopshtin e gjyshes sime.

— Më vjen keq që nuk mund të vij ta shoh...

I jep të fala. Po, mirë u kujtova, deshe gjë që erdhe, apo të dërgoi mësuesi?

— Unë erdha vetë. Nuk më dërgoi njeri. Mësuesi po vret mëndjen të gjejë mënyrën se si mund të dalë nga fshati.

— Ashtu?

— Edhe unë kam menduar, por...



— Pa të shohim një herë se mos kushedi e rregullojmë.

— Vërtet?

— Më erdhi diçka në mendje.

— Çfarë?

— Të djelën martohet Dafina, vajza e madhe e Zeqos, që rri afër shtëpisë së gjyshes sate. Ajo do të martohet në Qarrishtë...

— Pastaj?

— Sikur ta nisim edhe mësuesin me krushqit...

— Po si?

— E di vetë unë. Tani do të shkoj në shtëpinë e Zeqos. Ti, Pirro, prit tek dera e gjyshes. Kur të dal nga Zequa do të të jap një copë letër, sido që të venë punët. Ti pastaj shko çoja Himit.

— Më jep edhe ca cigare për mësuesin.

Doktori hapi dollapin e i dha një qese me duhan e letër.

U nisën të dy tok. Doktori ecte përpara dhe Pirrua pas. Pasi ecën ca, doktori tha:

— Po të pyesë njeri se kù shkon xhaxhi doktori, ti thuaju se Zequa ka të sëmurë një fëmijë. More vesh?

— Si urdhëron!

Duke biseduar, kishin arritur para shtëpisë së Zeqos.

Doktori u fut brënda, ndërsa Pirrua qëndroi para derës, në shtëpinë e gjyshes. Priti e prit shumë, aq sa u mërzit. Mos vallë Zequa nuk pranonte? Po sikur të mos pranonte si do të bënin?... Ç'njeri edhe ky Zequa! Pirrua jepte edhe jetën për mësuesin partizan, ndërsa ai nuk pranonte të bënte një gjë kaq të vogël...

Pasi e lexoi, Himi pyeti Pirron:

— Në shtëpinë e cilit duhet të shkoj?

— Në shtëpinë e Zeqos...

— Këtu, tek komshiu i gjyshes sate?

— Po.

— Pse, çfarë do të bëhet të djelën?

— Do të martohet Dafina...

— Aaaa... tani i kuptova të gjitha.

Mësuesi qeshi me gjithë zemër. Iu bë shumë qefi që kish patur një nxënës kaq të shkathët e kaq të zgjuar.

— Kush i mendoi të gjitha këto, Pirro?

— Xhaxhi-doktori.

— Vetëm xhaxhi doktori? Po ti, s'mendo-ve gjë? Nuk më besohet.

— Unë nuk bëra asgjë, vetëm solla letrën... tha Pirrua dhe uli kokën.

Mësuesi i shtrëngoi dorën dhe i tha:

— Pirro, unë të kam borxh jetën se ti më ke shpëtuar timen!



## IX

- Mirë u pafshim, Pirro!  
— Mirë u pafshim, shoku mësues!

Shtëpia e nuses ziente nga këngët dhe nga vallet. Nusja, e veshur krejt në të bardha, rrinte kokulur dhe shoqet i këndonin përreth. Burrat hanin e pinin në dhomën tjetër, ndërsa gratë e vajzat hidhnin valle. Gjithë natën e natës buçiti kënga e vallja. Këndonte edhe Pirrua me fëmijët e tjerë, që silleshin nëpër këmbët e dasmorëve.

Poshtë, në ahur, doktor Zota rrinte me mësuesin. Ata as hanin as pinin. Bisedonin.

Doktor Zota e kish veshur Himin si xhaxho. Mjekra e parruar dhe mustaqet që i vuri doktori i shkonin shumë fytyrës së tij të hequr e pak të gjatë. Pastaj poturet, jeleku dhe qylafi me majuc e pak i nxirë nga përdorimi, e bënë mësuesin të dukej si ndonjë plak shtatëdhjetëvjeçar.

Atë natë mësuesi me doktorin e gdhinë duke ndenjtur përballë njëri tjetrit, pa vënë gjumë në sy.

**N**ë të dalë të Qarrishtës qëndruan dy vetë:  
një burrë dhe një femijë. Ata u përqaftuan  
dhe burri tha:

— Mirë u pafshim, Pirro!

— Mirë u pafshim, shoku mësues!

---

Vuno — Tiranë, 1966.